

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Viti i 91-të i botimit
Shkurt 2023 / Nr. 2

Mbrojtja



Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi,
vizitë zyrtare në Pentagon

Përmbajtja

Numri 2

TAKIMI

- 5** Ministri Peleshi: Shqipëria do vazhdojë kontributin e saj drejt Ukrainës. Paketë tjetër donacionesh për Ukrainën

EMERGJENCAT

- 7** Strukturat e Forcave të Armatosura, angazhim maksimal për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet

ARSIMIMI

- 14** Zhvillohet ceremonia e betimit të studentëve të AFA-së

KOLEGJI I MBROJTJES DHE SIGURISË

- 19** Përfundon Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit

DOSSIER

- 22** 555-vjetori i përjetësimit të krenarisë kombëtare, Gjergj Kastrioti -Skënderbeu

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shefe e Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktore

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore / korrektore:
Suela HODA

4 BASHKËPUNIMI

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Pentagon

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë vizitës së tij zyrtare në SHBA, u prit në Pentagon nga sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III. Bisedimet e tyre u fokusuan në vazhdimin...



8 PRESIDENTI BEGAJ

Prioritet, procesi i rishikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike

Presidenti i Republikës z. Bajram Begaj mbledhi Këshillin e Sigurimit Kombëtar me qëllim analizimin e gjendjes së sigurisë kombëtare dhe prioritetet për vitin 2023...



24 INTERVISTË ME KOLONEL (R) THOMA KONDURI

Shekullimi i Armës së Artilerisë, vlerë e shtuar e FA-së

Për më shumë se një shekull jetë Arma e Artilerisë feston krijimin e saj, se si ka udhëtuar nëpër fatin, për të qenë e fortë në mbrojtje të atdheut si dhe transformimet e saj ndër...



28 SOCIALE

"Duam të bëhemi 'Zotër' dhe kjo na pengon të bëhemi njerëz"

Sot, më shumë se kurrë është e nevojshme që njeriu të njohë veten, sepse duket qartë, që ai është i prirur më shumë e më mirë të njohë planetët...



Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 91-të i botimit
Nr. 2/ 2023

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Revista mund të gjendet në formatin
elektronik (pdf) në adresën:

[http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/
publikime/revista-mbrojtja](http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja)





Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Pentagon

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, gjatë vizitës së tij zyrtare në SHBA, u prit në Pentagon nga sekretari amerikan i Mbrojtjes Lloyd J. Austin III. Bisedimet e tyre u fokusuan në vazhdimin e bashkëpunimit strategjik të Shqipërisë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë si dhe në forcimin e dialogut politik. Sekretari Austin dhe ministri Peleshi diskutuan për ndihmën që iu dha Shqipërisë nga Garda Kombëtare e



New Jersey-t pas sulmit kibernetik dhe ranë dakord të vazhdojnë të punojnë së bashku për të forcuar edhe më shumë aftësitë e mbrojtjes kibernetike të Ministrisë së Mbrojtjes së Shqipërisë.

Ministri i Mbrojtjes Peleshi shprehu falënderimet për mbështetjen e menjëhershme që dhanë ekipet e specializuara amerikane të mbrojtjes kibernetike, ndërsa shprehu nevojën që mbështetja e SHBA-ve të jetë më e zgjeruar edhe për sistemet e tjera në vend, veç atyre të Ministrisë së Mbrojtjes. Gjatë bisedës, Ministri Peleshi e konsideroi vitin e kaluar,



Ministri Peleshi: Shqipëria do të vazhdojë kontributin e saj drejt Ukrainës Paketë tjetër donacionesh për Ukrainën

Ministri i Mbrojtjes, zoti Niko Peleshi mori pjesë në takimim e Grupit të Kontaktit për Mbrojtjen e Ukrainës, që u zhvillua në Bazën Ajrore në Ramstein, Gjermani.

Ky ishte takimi i tetë i ministrave dhe shefave të shtabit të mbi 50 vendeve të botës si dhe të Ukrainës që prej fillimit të agresionit rus ndaj Ukrainës.

Takimi që u drejtua nga sekretari i Mbrojtjes së SHBA-ve z. Lloyd J. Austin III u fokusua në vijimin e ndihmës ushtarake për Ukrainën, si dhe çështjet e tjera të sigurisë, me të cilat përballen aleatët dhe partnerët e NATO-s.

Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi vlerësoi popullin ukrainas për kurajën dhe vendosmërinë e treguar si dhe lidhshypin e qeverisë, teksa po mbushet një vit që nga nisja e luftës. Gjithashtu, ministri Peleshi i shprehu ngushëllime ministrit ukrainas për jetët e humbura nga sulmet e fundit ruse ndaj popullit ukrainas.

Më tej, ministri Peleshi përmendi kontributin që Shqipëria ka ofruar për Ukrainën, ndërsa njoftoi përgatitjen e një pakete tjetër të konsiderueshme mbështetjeje.

Grupi i Kontaktit të Mbrojtjes për Ukrainën (UDCG), është një iniciativë e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA-ve, që mbledh së bashku aleatë dhe partnerë nga e gjithë bota, për të diskutuar mbi bashkëpunimin dhe sfidat e sigurisë që duhen përballuar si pasojë e agresionit rus në Ukrainë.

vit rekord sa i përket projekteve të përbashkëta me SHBA-të, duke përmendur këtu nisjen e punës për Bazën Taktike të NATO-s në Kuçovë, modernizimin e Forcës Ajrore me helikopterët "Black Hawk", si dhe projektet në edukimin ushtarak, etj.

Ministri Peleshi i prezantoi sekretarit amerikan të Mbrojtjes edhe projektin e portit të ri të Porto Romanos si dhe rëndësinë strategjike që ky port ka për rajonin, Evropën Juglindore dhe Aleancën e NATO-s. Gjithashtu theksoi angazhimin e vendit tonë për të qenë faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë, ndërsa u shpreh se Kosova është interesi ynë strategjik kombëtar dhe ne e mbështesim aspiratën euroatlantike të Kosovës. Sekretari Lloyd J. Austin III falënderoi ministrin Peleshi për pritjen që Shqipëria i bëri Stërviçjes "Defender Europe - 21" dhe të Brigadës së Ndihmës së Forcave të Sigurisë së Ushtrisë Amerikane. Sekretari Austin përgëzoi ministrin Peleshi për mbështetjen e palëkundur të Shqipërisë për Ukrainën, për angazhimin në NATO dhe përfshirjen në të gjitha operacionet e Aleancës.



FA DHE EMERGJENCA CIVILE NË KRYE TË DETYRËS

Ministri Peleshi: Prioritet jeta e njerëzve dhe pasuria e tyre

Ministrit i Mbrojtjes Niko Peleshi, në daljen e tij të radhës mbi situatën e motit në territorin e vendit tonë tha: "Nisur nga përkeqësimi i motit në 24 orët e fundit, edhe në ditët në vijim presim reshje të shumta sidomos në pjesën veriore të vendit. Natyrisht kjo na përball edhe me rrezikun e emergjencave të natyrave të ndryshme pothuajse në të gjithë vendin. Ndaj e vlerësoj të nevojshme jo vetëm për institucionet, por edhe për qytetarët të bëjnë një informacion si dhe të bëj me dije publikun lidhur me parashikimet e Institutit të Gjeoshkencave lidhur me prurjet në liqene, në përrenj, në lumenj, në përmytjet e mundshme si dhe masat që duhet të marrin qytetarët, bashkitë, prefekturat edhe të gjithë institucionet e tjera të zinxhirit të sistemit të EC.

Ishte parashikuar, e kemi paralajmëruar në 24 orët e fundit, se në pjesën e lumit Drin ka mbizotëruar mot i paqëndrueshëm dhe reshje shiu. Për 24 orë ka rënë mesatarisht 65 mm në basenin e Komanit, Vaut të Dejës dhe rreth 30 mm në basenin e Fierzës. Sasia më e madhe e reshjeve është regjistruar në Alpet e Shqipërisë, rreth 120 mm në Theth, Valbonë dhe rreth 100 mm në zonën e Pukës.

Reshjet e rëna deri tani janë përkthyer në këto vlera prurjesh: në Fierzë 450 m³/sek, në Koman 56 m³/sek dhe Vau Dejës rreth 130m³/sek. Deri tani në raportimet e 24 orëve të fundit nga qarqet nuk kemi situata problematike në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër dhe Lezhë. Mund të ketë vërshime të shpejta të lumenjve të vegjël malorë dhe rrëshqitje të dherave në zonat urbane në këto qarqe, mund të shfaqen probleme përmytjeje të lokalizuara në varësi të gjendjes së kanalizimeve, por dua të bëj këtu me dije se të gjitha shtabet e bashkive në drejtimin e institucionit të prefektit janë në gatishmëri. Janë marrë masa. Bashkitë kanë punuar në kohë për të parandaluar përmytjet e mundshme me pastrimin e kanaleve dhe masa të tjera.

Gjenerimi në kaskatë do të jetë i



përqendruar në regjim maksimal në HEC-in e Fierzës në hidrocentralin e Komanit, Vaut të Dejës. Priten reshje intensive në qarqet Shkodër dhe Kukës, reshje intensive në qarqet Dibër dhe Lezhë, mesatare dhe lokalisht intensive në qarqet e tjera të vendit. Në qarqet Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë, Elbasan, Vlorë dhe Gjirokastrë reshjet priten të shoqërohen dhe me shtrëngata. Reshje mesatare dhe intensive priten pothuajse në të gjitha zonat e tjera të vendit. Më të përqendruara siç e thamë dhe me intensitet me të lartë do të jenë në veri të Shqipërisë. Prurjet në kaskatë të lumit Drin do të pësojnë rritje për shkak të reshjeve të shiut me intensitet të lartë. Piku orar i prurjeve pritet të arrijë deri në vlerat: për Fierzën 2500 m³/sek, në Koman 2200 m³/sek, Vau i Dejës 1100 m³/sek; piku i orareve të prurjeve në lumin Drin pritet të arrijë deri në 5800 m³/sek.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka sjellë në vëmendjen e bashkive nga dita e djeshme rritjen e gatishmërisë së strukturave të Sistemit të Mbrojtjes Civile që kanë në administrim hidrovore, rezervuarë, infrastrukturë rrugore, furnizim me energji elektrike, furnizimin me ujë, monitorimin e nivelit të lumenjve dhe çdo strukturë tjetër,

që është në funksion të menaxhimit të EC".

Më tej ministri Peleshi u bën thirrje bashkive për të rritur gatishmërinë operacionale të kapaciteteve të tyre, konkretisht: "Bashkia Shkodër, ritheksoj nevojën për marrjen e masave për paralajmërimin e popullsisë veçanërisht në zonat e rrethinave të Shkodrës, të marrë masa për monitorimin e lumenjve të Bunës, Kirit dhe Drinit kontrollin e vazhdueshëm të gjendjes të argjinaturave të lumenjve si dhe të digave të ujëmbledhësve, kontrollin e funksionalitetit të hidrovoreve në zonën e Velipojës mbajtjen në gatishmëri të mjeteve të kontraktorëve të mirëmbajtjes së rrugëve.

Bashkia Lezhë të marrë masat për paralajmërimin e popullsisë veçanërisht në zonat e rrezikuara, monitorimin e lumit Drin, kontrollin e vazhdueshëm të argjinaturave digave ujëmbledhëse, kontrollin e funksionimit të hidrovoreve në zonën e Tales dhe Dorovicës, mbajtjen në gatishmëri të mjeteve të kontraktorëve të mirëmbajtjeve të rrugëve, mbajtjen në gatishmëri të kapaciteteve logjistike dhe burimeve njerëzore të forcave operacionale për përballimin e çdo situatë të mundshme.

Bashkia Dibër duhet të marrë

Strukturat e Forcave të Armatosura gjenden të angazhuara pranë popullsisë civile të prekur nga përmbysjet, si rrjedhojë e reshjeve të dendura të shiut në ultësirën veriperëndimore të vendit. Dy nga strukturat kryesore të FARSH-së, Forca Tokësore dhe Komanda e Mbështetëse, prej afro një jave, kanë qëndruar në krah të popullsisë civile të zonës së Shkodrës dhe Lezhës.

Mbi 50 trupa me mjete të kalueshmërisë së lartë kanë punuar këto ditë për të ndihmuar banorët e izoluar nga uji në fshatin Obot, Shkodër. Ndërkohë, forca dhe mjete nga Forca Tokësore dhe Komanda e Mbështetëse, gjatë ditës së enjte dhe të premte janë përqendruar në Lezhë, në gatishmëri për të vepruar në rast të përkeqësimit të situatës.

Gjithashtu, efektivet e Komandës Mbështetëse, ditën e enjte i janë gjendur pranë një familjeje në fshatin Rukaj, Mat, duke ngritur një çadër për strehimin e tyre, për shkak të dëmtimit të banesës nga tërmeti i disa ditëve më parë.

Reshjet e dendura të shiut kanë sjellë përkeqësim të situatës edhe në Republikën e Kosovës. Për t'i ardhur në ndihmë vëllezërve matanë kufirit, Forcat e Armatosura vendosën në gatishmëri mbi 35 forca 6 mjete dhe një motobarkë, të cilat u përqendruan në Kukës në pritje të kërkesës për ndërhyrje.

Forca Tokësore, vijon edhe sot të ketë personel dhe mjete të angazhuara në Obot, Shkodër, ku edhe pse personeli është i reduktuar si rrjedhojë e përmirësimit të situatës, efektivet e batalionit të Parë të Këmbëorisë, vijnë kontributin e tyre për transportin e banorëve të zonës, të cilët për shkak të nivelit ende të lartë të ujit, nuk mund të lëvizin nga dhe drejt banesave të tyre.



Strukturat e Forcave të Armatosura, angazhim maksimal për përballimin e situatës së krijuar nga reshjet



masa për paralajmërimin në kohë të popullsisë veçanërisht në zonat ku ka përrenj, të cilët priten të rrisin prurje dhe të rrezikojnë bllokimin e rrugëve, apo banesat përreth, kontrollin e vazhdueshëm të argjinaturave dhe digave ujëmbledhëse, mbajtjen në gatishmëri të mjeteve për mirëmbajtjen e rrugëve në bashkëpunim dhe me kontraktorët si dhe të gjitha kapacitetet e tjera logjistike të sistemit të emergjencave.

Në bazë të parashikimit për situatën hidrologjike të përkeqësuar në gjirin e Vlorës janë marrë masa në drejtimin e institucionit të prefektit: është ndaluar dhënia e leje nisjeve gjatë datave 16, 17, 18 dhe 19 janar për të gjitha mjetet e vogla lundruese anijeve të peshkimit që operojnë jashtë gjirit të Vlorës dhe gjithashtu janë njoftuar këto anije për marrjen e masave dhe sigurimin e tyre. Mjetet e

vogla lundruese dhe anijet e peshkimit që operojnë brenda gjirit të Vlorës duhet të kenë në konsideratë kushtet e parashikuara dhe të marrin masa për sigurimin e tyre.

Janë njoftuar drejtuesit e anijeve të peshkimit dhe mjetet e vogla lundruese për situatën e përkeqësuar në vendet e parkimeve të mjeteve dhe parandalimin e situatave gjatë ditëve në vazhdim. Anijet e transportit detar do të vazhdojnë të operojnë normalisht.

Për shkak të uljes së temperaturave do të ketë edhe reshje bore ndaj të kemi parasysh se pranë çdo bashkie funksionon një shtab emergjencash.

Institucioni i prefektit duhet të jetë akoma më tepër në bashkëpunim me të gjitha bashkitë dhe sidomos me të gjithë rrjetin e kryeqendrave të fshatrave

sepse së pari qytetarët duhet të jenë të informuar se ku priten rrëshqitje, ku priten emergjenca, ku priten përmbysje dhe t'i shmangin ato sa më shumë të jetë e mundur.

Natyrish në këtë sezon të vështirë të disa ditëve me reshje, të gjithë së bashku edhe në bashkëpunim, siç është bërë tani e konsoliduar, do të kemi prioritet jetën e njerëzve dhe pasurinë e tyre më pas, do të jemi në komunikim të vazhdueshëm me publikun për çdo situatë dhe gjithashtu mirëpresim ndarjen e informacionit jo vetëm nga sistemi i institucioneve që funksionon më së miri por dhe nga qytetarët e thjeshtë që ndonjëherë mund të jenë decisive për të ndërhyrë në kohë dhe për të marrë masa, duke na lajmëruar sa më herët për ndonjë emergjencë lokale të shfaqur në territor".

Prioritet, procesi i rishikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike

Presidenti i Republikës z. Bajram Begaj mbledhi Këshillin e Sigurimit Kombëtar me qëllim analizimin e gjendjes së sigurisë kombëtare dhe prioritetet për vitin 2023.

“Viti që lamë pas, ishte i vështirë dhe sfidues për sigurinë kombëtare. Sulmi kibernetik shkaktoi probleme në infrastrukturën digjitale. Në aspektin rajonal, pati përpjekje nga shtete me interesa jo-miqësore për frenimin euroatlantik të tij”, - deklaroi në nisje të mbledhjes kreu i shtetit.

Në përfundim të mbledhjes së Këshillit të Sigurisë, Presidenti Bajram Begaj kërkoi që të trajtohen me prioritet procesi i rishikimit dhe hartimit të dokumenteve strategjike, Strategjisë së Sigurisë Kombëtare, dokumenteve strategjike në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë, emergjencave civile, si dhe strategjive sektoriale.

Pas raportimeve dhe diskutimeve në Këshillin e Sigurimit, Presidenti i Republikës Bajram Begaj e vlerësoi si shumë të rëndësishëm këtë takim dhe angazhimin e të gjitha institucioneve për garantimin e sigurisë kombëtare në fushën e tyre të përgjegjësisë. Presidenti theksoi si të rëndësishëm bashkërendimin, përpjekjet dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes institucionale, përdorimit efikas të burimeve kombëtare dhe kërkimit të kontributit të çdo qytetari në funksion të sigurisë kombëtare.

Po ashtu presidenti Begaj kërkoi në takim që dokumentet strategjike nuk duhet të jenë thjesht dokumente formale, duhet të jenë të mirë buxhetuara dhe të sigurojnë përdorimin në mënyrë të koordinuar dhe harmonizuar të instrumenteve të fuqisë kombëtare në garantimin e sigurisë, të nxisin zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, të rrisin mirëqenien e qytetarëve, dhe të sigurojnë mbrojtjen e vlerave dhe interesave kombëtar të Republikës së Shqipërisë.

Viti 2022 sfidues për sigurinë kombëtare

Në fjalën e tij, Presidenti u shpreh se viti që lamë pas ishte i vështirë dhe sfidues për sigurinë kombëtare. “Në muajin korrik, ne u përballëm me një nga sulmet më të rënda kibernetike të sponsorizuara nga struktura shtetërore të Republikës Islamike të Iranit, i cili jo vetëm shkaktoi probleme në infrastrukturën digjitale në vend,





por ishte me qëllime të dukshme politike për të shkaktuar destabilitet”, - theksoi z. Begaj.

Z. Begaj tha po ashtu se: “Gjatë vitit 2022 kemi kaluar situata të vështira që lidhen me përmbytjet gjatë periudhës së dimrit, situatë e vështirë është krijuar dhe këto dy javët e fundit, si dhe zjarret gjatë periudhës së verës. Gjithashtu ka pasur cenim të sigurisë publike nga fenomene të kriminalitetit, aktivitete të paligjshme të trafikut të lëndëve narkotike, krimit të organizuar, korrupsionit, emigracionit etj. Të gjitha këto kanë ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve”.

Presidenti Bajram Begaj, në fjalën e tij gjithashtu ngriti si shqetësim ndikimin e huaj në rajon. Sipas tij, ka shtete jo miqësore që duan të kenë ndikimin e tyre në Ballkan. “Në aspektin rajonal ka patur zhvillime me ndikim direkt apo indirekt në ruajtjen dhe mbrojtjen e interesave tona kombëtare, ndërkohë që shtete me interesa jo miqësore, nëpërmjet

instrumenteve të ndryshëm janë përpjekur të zgjerojnë influencën e tyre dhe të frenojnë proceset integruuese euro-atlantike të vendeve të rajonit tonë”, - tha presidenti.

Më tej ai tha se lufta në Ukrainë ka shkaktuar pasoja në të gjithë botën, përfshirë dhe në vendin tonë. Për këtë arsye është diskutuar mbi sigurinë ushqimore. “Agresioni i paligjshëm i Rusisë ndaj Ukrainës ka shkaktuar krizën më të madhe të sigurisë në hapësirën euro-atlantike, ndërsa efektet e tij në fushën ekonomike u shoqëruan me rritje të konsiderueshme çmimesh në sektorin ushqimor dhe të energjisë të cilat kanë shtrenjtuar dhe vështirësuar jetën e qytetarëve. Prandaj në këtë takim, do bëjmë një analizë të gjendjes së sigurisë kombëtare dhe ajo ç’ ka është më e rëndësishme është të diskutojmë prioritetet për vitin në vijim, në funksion të një angazhimi të plotë dhe gjithëpërfshirës të të gjitha institucioneve, për të siguruar bashkërendimin e për-

pjekjeve dhe përdorimin efikas të burimeve kombëtare në funksion të sigurisë, lirisë dhe mirëqenies”.

Një çështje tjetër mbi të cilën u ndal presidenti Begaj ishte situata në Kosovë, ku u shpreh se vendi ynë do të jetë në krah të Kosovës për të garantuar paprekshmërinë territoriale. “Përgjatë gjithë vitit dhe në fund të dhjetorit të vitit të kaluar, u ballafaquam me një situatë tepër delikate në veri të Kosovës, e cila nuk kontribuon në paqen dhe stabilitetin rajonal. Shqipëria është në krah të Kosovës dhe vlerëson ruajtjen e paprekshmërisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës, vlerëson rolin dhe kontributin e misionit KFOR të NATO-s në garantimin e paqes dhe sigurisë, respekton parimet e fqinjësisë së mirë, si dhe mbështet dhe inkurajon dialogun Serbi-Kosovë të ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe mbështetur nga SHBA-të, për arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare, që do të çojë në njohje të ndërsjellë”.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Fuqizojmë sigurinë kibernetike, rrisim pagat e ushtarakëve

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, i shoqëruar nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji dhe drejtori i Përgjithshëm AKMC, Haki Çako, prezantuan në një konferencë për mediat arritjet gjatë vitit 2022 si dhe objektivat e projektet e reja për vitin 2023 në fushën e Mbrojtjes si edhe të Mbrojtjes Civile.

Sipas ministrit Peleshi, në 2022 nisi puna për ndërtimin e Bazës Taktike ajrore të NATO në Kuçovë.

Ministri theksoi se kjo është e para bazë ajrore e NATO-s dhe jo pa qëllim është zgjedhur Shqipëria. "Shqipëria ka pozicion strategjik në Ballkanin Perëndimor, por është edhe vend aleat i NATO-s, i sigurt, i qartë në orientimin e vet edhe ka një rol të rëndësishëm për të luajtur edhe në vendet ku jetojnë shqiptarë: në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, por edhe vende të tjera", - tha Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes deklaroi se gjatë 2022 përfundoi faza e parë e projektit të komunikimit Tokë - Ajër - Tokë (GAG) si dhe u nënshkrua marrëveshja për shtimin e flotës ajrore me avionë luftarakë pa pilotë me kompaninë turke "Baykar Technologies".

"Dronët 'Bayraktar' kanë reputacion, pasi kanë provuar të jenë të suksesshëm në kuptimin e aftësisë së tyre mbrojtëse ushtarake, por ne do t'i përdorim ato edhe për qëllime civile, madje shpresojmë të mos i përdorim për qëllime të tilla. Të kombinuar edhe me shërbimet satelitore do të na japin një potencial të jashtëzakonshëm, i cili ka nevojë të dijë vetëm të përdoret", - tha Peleshi.

Sa i përket satelitëve "Albania 1" dhe "Albania 2", Peleshi tha se imazhet që do sigurohen prej tyre do të kontribuojnë në shumë elementë.

"Shërbimet satelitore mund të jenë edhe komerciale në kuptimin që t'u vendosen në dispozicion për shembull fermave bujqësore, por edhe operatorëve të tjerë që kanë nevojë për imazheri të saktë satelitore", - tha ministri Peleshi.

"Satelitët japin informacionin. Ju siguroj që satelitët do jenë një mjet i rëndësishëm për t'u përdorur nga institucione e Policisë së Shtetit. Kur investon në teknologji investon për të kursyer. Janë kursim kohe dhe parash. Ne kemi një agjenci shtetërore që kanë bërë një punë fantastike. Këto dy kapacitete do jenë vlerë e shtuar, por edhe kursim parash për buxhetin e shtetit", - deklaroi Peleshi.



Gjithashtu, ministri tha se "Forcat e Armatosura do të kenë pjesë të saj sistemin raketor antitank 'Javelin' dhe atë kundërajtor 'Stinger'".

Ministri i Mbrojtjes nënvizoi faktin se gjatë vitit 2022 pagat e ushtarakëve u rritën në masën 30%, duke theksuar se rritja do të vijojë edhe gjatë vitit 2023 me 7% për të gjitha gradat, ndërsa njoftoi edhe implementimin e paketës sociale për ushtarakët.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi thotë se këtë vit do t'i jepet më shumë prioritet fushës së sigurisë kibernetike. Ai tha gjatë konferencës për shtyp se këtë vit do të ndërtohet qendra operationale e fushës kibernetike. Ministri Peleshi u shpreh se: "2023 do të jetë viti kur njësia ushtarake e Mbrojtjes Kibernetike do të ketë plotësuar 100% kapacitetet e veta njerëzore. Jemi në një proces rekrutimesh, kemi ndryshuar strukturën;

kemi trefishuar numrin e kapaciteteve në strukturë; kemi rritur pagat, i kemi bërë fleksibël, pasi ju e dini: burokracia shtetërore nuk të lejon të dalësh nga kategoritë e pagave të caktuara, por për specialistët e fushës së IT-së dhe Sigurisë Kibernetike po aplikon një regjim të veçantë fleksibël dhe kompetitiv", - nënvizoi Peleshi.

Vëmendje e veçantë gjatë vitit 2023 do t'u kushtohet edhe Emergjencave Civile, pas investimeve që u kryen gjatë vitit 2022. Dy avionë dhe mjete të posaçme për Mbrojtjen Civile do i shtohen vendit tonë me anë të kredisë me vlerë 30 milion euro pas marrëveshjes me Italianë, sipas ministrit Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes u shpreh se Shqipëria do të rrisë kontributin e saj në misionet jashtë vendit, ndërsa theksoi mbështetjen materiale dhe politike për Ukrainën.



Niset në hapësirë raketa “Falcon 9” me dy satelitët “Albania 1” dhe “Albania 2”

Raketa “Falcon 9”, misioni i përbashkët i SpaceX Transporter 6, e cila transporton edhe satelitët “Albania 1” dhe “Albania 2”, u lëshua në hapësirë nga stacioni Cape Canaveral, Florida, më datë 03.01.2023 në orën 9:56 me orën lokale, 14:56 me orën në Tiranë. Dy satelitët lëshohen në kuadër të kontratës së shërbimit satelitor në fushën e Mbrojtjes dhe Sigurisë për monitorimin me teknologji të avancuar të territorit të Republikës së Shqipërisë ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile dhe Operatorit “Satellogic USA Inc.”, me vlerë 6 milion dollarë. Në bazë të kontratës, dy satelitët do të përdoren për një periudhë 3 - vjeçare, për monitorimin e territorit të Republikës së Shqipërisë, zhvillimin e kapaciteteve teknike e profesionale të Republikës së Shqipërisë për përdorimin e shërbimit satelitor, përpunimin e informacionit gjeohapësinor (GIS) si dhe ofrimin e produkteve të imazherisë dhe komponentëve të tjerë të saj. Ky shërbim do t’u mundësojë institucioneve përfituese marrjen e imazheve satelitore, të cilat sigurojnë një mbulim gjithëpërfshirës dhe periodik të sipërfaqes tokësore, duke mundësuar përdorime të shumta dhe një mori informacionesh dhe gjeoinformacioni për vendimmarrësit dhe planifikuesit si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, për politika dhe vendimmarrje efektive.

SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji merr pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s në Bruksel

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji mori pjesë në takimin e 188-të të Komitetit Ushtarak të NATO-s në Bruksel.

Në këtë takim, vëmendje të veçantë mori diskutimi mbi sfidat e reja me të cilat përballlet Aleanca dhe nisja e një faze të re të mbrojtjes kolektive.

Takimi u përcoll me një mesazh të qartë ndaj përkushtimit të vendeve anëtare për një bashkëpunim sa më të ngushtë në implementimin dhe ndërthurjen e koncepteve dhe planeve të reja të mbrojtjes së NATO-s; si dhe mbështetjen e përbashkët ndaj luftës në Ukrainë dhe ecurinë e misionit KFOR, në ruajtjen e qëndrueshmërisë së sigurisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Përgjatë sesioneve dyditore të takimit, gjeneral brigade Kingji paraqiti qëndrimin zyrtar të Shqipërisë dhe FARSH-së, duke vlerësuar maksimalisht rolin e NATO-s në përgjigje ndaj zhvillimeve të fundit brenda Aleancës dhe në rajonin tonë.



SHSHPFA, gjeneral brigade Arben Kingji: Shqipëria do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm, duke iu bashkuar çdo nisme dhe kontributi në ndihmë të Ukrainës

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneral brigade Arben Kingji priti në një takim ambasadorin ukrainas Volodymyr Shkurov. Pasi i uroi mirëseardhjen, gjeneral brigade Kingji e njohu ambasadorin Shkurov me zhvillimet dhe arritjet më të fundit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë takimit, gjeneral brigade Kingji e siguroi ambasadorin ukrainas se Shqipëria në bashkëpunim me SHBA-të, vendet anëtare të NATO-s, si dhe ato partnere, do të vazhdojë të luajë një rol të rëndësishëm duke iu bashkuar çdo nisme dhe kontributi në ndihmë të Ukrainës.

Nga ana e tij, ambasadori Shkurov shprehu mirënjohjen për mbështetjen dhe bashkëpunimin e deritanishëm mes dy vendeve, duke falënderuar për ndihmën që Forcat e Armatosura dhe Shqipëria kanë dhënë dhe do japin në ndihmë të ushtrisë dhe popullit ukrainas në këtë situatë mjaft të vështirë dhe kritike për vendin e tij.

Të dy bashkëbiseduesit shprehën besimin dhe dëshirën e vijimit dhe forcimit të mëtejshëm të bashkëpunimit ushtarak midis dy vendeve.



SHSHPFA, takim me personelin nënoficer

Në sallën e auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua takimi me shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneral brigade Arben Kingji dhe personelin nënoficer kryekapiter/kapter të FA-së.

Në këtë takim u ndanë mendime, ide, si dhe këshillat për fuqizimin e rolit të nënoficerit si instruktor, planëzues stërvitjeje dhe ekspert i zoti në çdo fushë, përmes disiplinës, kërkesës për vetëzhvillim dhe punës profesionale të vazhdueshme.

Të gjithë trupës së nënoficerëve, gjeneral brigade Kingji iu shprehu falënderimet e tij për karakterin, integritetin dhe motivimin e fortë që ekziston mes tyre, duke treguar cilësitë më të mira në çdo stërvitje dhe angazhim, brenda dhe jashtë vendit.





Zhvillohet ceremonia e betimit të studentëve të AFA-së

Në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua ceremonia e betimit të studentëve dhe kadetëve të rinj.

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin ministri i Mbrojtjes z. Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, komandantë forcash, drejtorë, si dhe familjarë e të afërm të studentëve.

Në fjalën e tij përshëndetëse, dekani i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Ilirjan Dauti, falënderoi të pranishmit, si dhe familjarët e studentëve për mbështetjen që u kanë dhënë në zgjedhjen e një profesioni kaq të bukur, por plot sfida dhe sakrificë.

“Ju sot vini më një status të vlerë, nga një qytetar i zakonshëm në një ushtarak të devotshëm. Të aftë fizikisht dhe psikologjikisht për të përballuar sfidat që do ju dalin përpara.

Të vetëdijshëm se të qenit ushtarak nuk e bën dot çdokush, por ai që ka vullnetin, moralin dhe motivacionin për t’i shërbyer popullit dhe atdheut.

Jemi të bindur se rrugën e nisur do ta përfundoni me sukses të plotë.

Atdheu nga sot do të këtë dhe 80 luftëtarë të tjerë, të gatshëm për t’u sakrifikuar për të”, - do të mbyllte fjalën e tij kolonel Dauti.

Ministri i Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, në fjalën e tij u shpreh se ishte një kënaqësi krejt e veçantë të ishte i pranishëm në këtë ceremoni, si dhe foli për transparencën dhe meritokracinë gjatë procesit të përzgjedhjes mes shumë kandidatëve të tjerë.



“Para tre muajsh, falë rezultateve dhe meritave tuaja, u përzgjedhët për t’iu bashkuar Forcave tona të Armatosura. Nderi, Detyra, Atdheu janë pasaporta juaj morale me të cilën do të përfaqësoni denjësisht kombin shqiptar ku do t’ju thërrasë detyra”, - u shpreh z. Peleshi, i cili nuk la pa përmendur sfidat me të cilat studentët dhe kadetët e rinj do të përballen.

“Në të ardhmen, një pjesë e mirë e juaja do të kenë mundësinë për të shërbyer në angazhimet dhe operacionet jashtë vendit, për të cilat jam i bindur që, ashtu si dhe paraardhësit tuaj, do të lini gjurmët tuaja të lavdisë”.

Në fund të fjalës së tij, ministri Peleshi përmendi edhe një herë

punën dhe përkushtimin e kuadrove dhe gjithë efektivit jo vetëm për stërvitjen, por edhe për përmirësimin e kushteve të punës, stërvitjes, jetesës dhe i siguroi se mbështetja e tij personale apo e Ministrisë së Mbrojtjes do të jetë e vijueshme, jo vetëm për këtë strukturë, por për të gjithë Forcat e Armatosura.

“Politikat mbështetëse të Qeverisë dhe Ministrisë së Mbrojtjes për motivimin mbështetjen, përkujdesjen, modernizimin, dhe arsimimin cilësor me pikësynim arritjen e standardit të akademisë “West Point”, do jenë fokus kryesor për vazhdimësinë”.

Në fund të ceremonisë studentë dhe kadetë bënë betimin e tyre nën flamurin shqiptar.

Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO-s, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, vizitojnë AFA-në

Në kuadër të planit vjetor të Atasheve Ushtarakë, të akredituar në Republikën e Shqipërisë, AU të vendeve të NATO-s vizituan AFA-në. Ata u pritën nga komandanti AFA-së, gjeneral brigade Bilbil Bitri, i cili i njohu ata me zhvillimet e fundit të AFA-së. Në veçanti u theksua procesi i transformimit të AFA-së sipas modelit të Akademisë Amerikane "West Point", një prioritet që ka vëmendjen edhe të Qeverisë Shqiptare, Ministrit të Mbrojtjes, Shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe që mbështetet edhe nga aleati strategjik SHBA.

Gjeneral Bitri i falënderoi atashetë për mbështetjen që vendet e tyre kanë dhënë në drejtim të arsimit të



oficerëve, ku aktualisht janë rreth 51 studentë që studiojnë në SHBA, Turqi, Itali, Gjermani, Greqi, Kosovë.

Atashetë Ushtarakë vlerësuan arritjet e AFA-së dhe gatishmërinë për vijimin e bashkëpunimit ushtarak bilateral.

AFA zhvillon "FACULTY FOUNDATION DEVELOPMENT PROGRAM"

U zhvillua programi trajnues "FACULTY FOUNDATION DEVELOPMENT PROGRAM", në FMS nga Shoqëria për Partneritet për Paqe për Akademitë Ushtarake dhe Institucionet e Studimeve të Sigurisë.

Objektivi i këtij trajnimi ishte që në përfundim të tij pjesëmarrësit të njiheshin, përvetësonin dhe aplikonin sa më shumë nga metodat të cilat shërbejnë për planifikimin e leksioneve dhe kurrikulave, duke pasur parasysh ruajtjen e raportit të nivelit ndërmjet pritshmërive, strategjisë së implementimit dhe vlerësimit të leksioneve, kurrikulave apo programeve.

Trajnimi u zhvillua në mënyrë interaktive, ku vlen të theksohet se jo vetëm u mësuan dhe praktikuan metodat e mësimdhënies, hartimit të leksioneve e programeve dhe vlerësimit të tyre, por u zhvilluan diskutime të frytshme nga shkëmbimi i eksperiencave të gjithsecilit prej pjesëmarrësve, duke mësuar shumë nga njëri-tjetri. Objektivi i trajnimit u përmbush dhe



pjesëmarrësit u pajisën me një paketë njohurish teoriko-praktike, të cilat janë të aplikueshme dhe të vlefshme për sferën e ushtrimit të profesionit të mësimdhënies po ashtu edhe të zhvillimit të planeve, programeve apo



kurrikulave.

Në përfundim të trajnimit për të gjithë pjesëmarrësit në këtë fazë të trajnimit si dhe në fazën e parë të tij, të zhvilluar gjatë vitit 2022, u shpërndanë certifikatat përkatëse.



Forca Ajrore trajnon pilotët e Njesisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës

Në Bazën Ajrore Farkë u zhvillua ceremonia me rastin e përfundimit të programit të rifreskimit teorik dhe praktik të fluturimeve me helikopterin tip AB-206, me qëllim ruajtjen e aftësive fluturuese (operacionalitetit) të pilotëve të njesisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës.

Në këtë aktivitet mori pjesë Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në Shqipëri, kolonel Enver Hoti, komandanti i Njesisë Ajrore të FSK-së n/ kolonel Enver Gërguri si dhe ushtarakë të tjerë të Forcës Ajrore.

Ceremonia u hap nga gjeneral Pulaj, i cili përgëzoi instruktorët e fluturimit të Bazës Ajrore Farkë dhe pilotët e FSK-së, për seriozitetin e treguar gjatë kësaj faze, si dhe përkushtimin e të gjithë personelit që ka bërë të mundur përfundimin me sukses të kësaj praktike fluturuese. Ky trajnim është një gur kilometrik për Forcën Ajrore sepse për herë të parë në

historinë e aviacionit shqiptar, zhvillohet trajnim i personelit pilot i një shteti tjetër.

Komandanti i njesisë së Aviacionit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, n/kolonel Enver Gërguri, në fjalën e tij përshëndetëse shprehu se: "Është një nder dhe privilegj që ne fluturojmë krah për krah me Forcat Ajrore Shqiptare, në veçanti falënderoj gjeneral Pulaj, për angazhimin e treguar në mbarëvajtjen e kësaj marrëveshjeje, e cila shpresojmë të vazhdojë sa më gjatë".

Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave të trajnimit, për rifreskimin teorik dhe praktik të fluturimeve me helikopterin tip AB - 206.



Në mjediset e Qendrës Stërvitore Kuçovë, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit Bazë të Oficerit (KBO) në specialitetin "Forcë Ajrore", i cili zgjati tre muaj.

Në këtë ceremoni morën pjesë komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë, kolonel Adrian Kuli, komandanti i Qendrës Stërvitore, major Ervin Demo si dhe përfaqësues nga Komanda e Forcës Ajrore.

Në fjalën e tij, kolonel Adrian Kuli, në emër dhe të komandantit të Forcës Ajrore, falënderoi instruktorët, kursantët dhe pjesëmarrësit për mbarëvajtjen e kursit dhe për rezultatet e arritura. Më pas ai theksoi rëndësinë e kualifikimeve të trupës së oficerëve për ecjen e tyre në karrierë dhe përballimin e sfidave në kuadër të zhvillimeve të pritshme në Forcën Ajrore.

Ceremonia përfundoi me shpërndarjen e certifikatave për oficerët të cilët përfunduan KBO.

Përfundon Kursi Bazë i Oficerit në Qendrën Stërvitore të Forcës Ajrore në specialitetin "Forcë Ajrore"



Nisën rrugëtimin për t'u bërë pjesë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë të rinjtë dhe të rejtat që u përzgjedhën në testimin përfundimtar që u zhvillua pranë Qendrës së Personel Rekrutimit. Rekrutët e rinj u përshëndetën nga komandanti i Qendrës së Personel Rekrutimit, kolonel Altin Gjetaj, si dhe në emër të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura përshëndeti drejtori i Shtabit, kolonel Arben Zani.



Kursi "Komando", konsiderohet si një nga kurset më të vështira, që zhvillohet në Regjimentin e Operacioneve Speciale (ROS). Për mbi 72 orë, kandidatët për beretën blu iu nënshtruan stërvitjes komplekse në rajonin e Fekenit, ku testuan aftësitë dhe rezistencën e tyre psiko-fizike.

"Junior Command and Leadership Course" po zhvillohet në Forcën Tokësore, nën drejtimin e instruktorëve britanikë, të British Military Advisory Training Team (BMAT), synon rritjen e aftësive profesionale, në fokus ato të lidershit ushtarak të rolit bazë oficer dhe nënoficer.



30 trupa nga batalioni i Tretë i Këmbësores (b3k), u nisën me mision në Pejë, Kosovë, si pjesë e misionit të NATO-s, KFOR.

Në ceremoninë e organizuar me këtë rast, në ambientet e b3k merrnin pjesë: kryetaria e bashkisë Dimal znj. Juliana Mema, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, miq dhe familjarë të efektivave të kontingjentit paqeruajtës etj.

Fjala e hapjes u mbajt nga komandanti i b3k, kolonel Gëzim Marku, i cili ndër të tjera theksin e vuri tek eksperiencia e krijuar nga efektivët e b3k ndër vite, për sa i takon pjesëmarrjes në operacione paqeruajtëse. Është kjo eksperiencë, por edhe trajnimi i vijueshëm që kryhet në këtë repart ato që sipas kolonel Markut, e mbushin me besim se ky mision do të jetë i suksesshëm, ashtu si edhe misionet paraardhëse.

Të pranishmit, i përshëndeti në emër të kontingjentit komandanti i këtyre efektivëve, major Mariglen Tomani, i cili, pasi falënderoi eprorët për besimin e treguar, i siguroi ata se misionin që iu është ngarkuar, do ta kryejnë me devotshmëri dhe profesionalizëm. Duke marrë fjalën në ceremoni, zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore gjeneral Dimo ndër të tjera tha: "...sot është një ditë e veçantë dhe kuptimplotë. Ceremonia e sotme, i bashkohet dhjetëra ceremonive të organizuara me raste të tilla nga Forca Tokësore, jo vetëm për të

Forca Tokësore nis kontingjentin e I shtesë në kuadër të misionit KFOR



përcjellë, por edhe të për të nderuar dhe respektuar djemtë dhe vajzat e saj më të mirë nën uniformë. Misioni, ku ju shkoni sot është një mision në shërbim të paqes dhe sigurisë. Ju do jeni ambasadorët tanë më të mirë në rajon. Mbajeni lart flamurin tonë kombëtar dhe emrin shqiptar, duke treguar çdo ditë nivelin tuaj profesional në bashkëveprim me aleatët. Qëndroni përkrah njëri-tjetrit, në çdo situatë dhe në çdo nevojë....".

Në mbyllje të fjalës së tij, gjeneral Dimo i siguroi familjarët e paqeruajtësve të kontingjentit I shtesë me mision në Kosovë, se Forca Tokësore,

por edhe Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes do të jenë gjithmonë në kontakt me ta dhe pranë tyre, për çdo problem apo nevojë që do të kenë.

Kontingjenti I shtesë, përbëhet nga një togë e efektivëve të batalionit të Tretë të Këmbësores dhe do t'i bashkohet trupave të kontingjentit të Forcës Tokësore që ndodhen aktualisht në Pejë, Kosovë në kuadër të misionit KFOR.

Me nisjen e këtij kontingjenti, Forca Tokësore shton kontributet e saj në interes të paqes dhe sigurisë rajonale.

Zhvillohet ceremonia e përfundimit të Kursit XVIII "Komando"

Në ambientet e Regjimenteve të Operacioneve Speciale (ROS), u zhvillua ceremonia e përfundimit të kursit XVIII "Komando", ku ndër të tjerë merrnin pjesë: zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Ferdinant Dimo, komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, komandanti i Forcës Detare, kundëradmiral Adnand Agastra, komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bilbil Bitri, drejtori i Shtabit të Përgjithshëm, kolonel Arben Zani, atasheu ushtarak i Republikës së Kosovës në vendin tonë, major Enver Hoti, komandantë të reparteve vartës të FT etj.

Aktiviteti u hap nga komandanti i ROS, nënkolonel Ajet Jata, i cili theksoi se: "Përgjatë 14 javëve stërvitje, me fokus në taktikat "komando", përgatitje zjarri, drejtim trupash, alpinizëm, topografi, përgatitje fizike etj., me plot bindjen ju themi se aftësitë e çdo kursanti tashmë janë të ndryshme nga aftësitë e çdo ushtaraku tjetër".

Një falënderim dhe përgëzim të veçantë, komandanti i ROS adresoi edhe për kursantët nga Republika e Kosovës, të cilët treguan përgatitje dhe formim të lartë ushtarak gjatë gjithë kursit.

Ceremoninë e përshëndeti edhe zëvendëskomandanti i Forcës Tokësore,



gjeneral brigade Ferdinant Dimo, i cili pasi përgëzoi kursantët për këtë arritje në karrierën e tyre, ndër të tjera tha: "...përfundimi i çdo lloj kursi, është për ne ushtarakët një tullë më tepër në murin e karrierës tonë, por përfundimi i një kursi të tillë, siç është kursi "komando", të cilët ju arritët ta përfundoni me sukses, është një krenari e shtuar për vetë faktin se jo të gjithë janë të aftë të marrin iniciativa të tilla të guximshme, për t'iu nënshtruar ngarkesës së madhe psikologjike dhe fizike, që parashikon programi stërvitor i këtij kursi. Duhet të ndiheni krenarë, që pas kaq sakrificash të mëdha ju treguat se mund

t'ia dilni. Vendosmëria, disiplina dhe shpirti i sakrificës që ju treguat, duhet të jetë shembull edhe për ushtarakët e tjerë, jo vetëm të Forcës Tokësore, por të të gjithë Forcave të Armatosura. Forca Tokësore është krenare gjithashtu që ka në mesin e saj njerëz të kalibrit tuaj të përgatitur dhe të gatshëm për t'u përballur me çdo sfidë...."

Të pranishmit në ceremoni, patën rastin të shikojnë nga afër nëpërmjet stacioneve stërvitore, disa demonstrime nga taktikat "komando".

Ceremonia u mbyll me betimin "komando" dhe me vendosjen e beretës blu.

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia: Privilegj që kjo shkollë mban emrin e heroit tonë Klodian Tanushi

Në shkollën 9 - vjeçare në Qesarakë, e cila mban emrin e Dëshmorit të Atdheut Klodian Tanushi, u bë inaugurimi i muzeut të shkollës. Në ambientet e kësaj shkolle është bërë gjithashtu dhe dhurimi i librave për bibliotekën e shkollës nga dhurues të ndryshëm.

Në këtë ceremoni morën pjesë familjarë të dëshmorit të atdheut Klodian Tanushi, deputetë të zonës, komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia si dhe përfaqësues nga Batalioni i Xhenios të Komandës Mbështetëse.

Hapja e ceremonisë nisi me përshëndetjen e drejtorit të shkollës, i cili mirëpriti të gjithë të pranishmit dhe falënderoi shoqatën 'Lidhja e Intelektu-



alëve dibranë' për kontributin e dhënë për shkollën "Klodian Tanushi" dhe veçanërisht për 400 librat e dhuruar për bibliotekën e kësaj shkolle, si dhe për krijimin e muzeut të shkollës, falënderoi familjen e Klodianit. Më pas fjalën e mori z. Shpëtim Cani, ku

u shpreh se dhurimi i këtyre librave është simboli i përjetësisë së heroit dhe i trashëgimisë arsimdashëse të një krahine si Dibra, ku ndjejmë përgjegjësinë që këtë traditë t'ua transmetojmë brezave të rinj. Edhe babai i Klodianit, z. Basri i falënderoi të gjithë për angazhimin dhe përkushtimin ndaj veprimtarisë kushtuar Klodian Tanushit. Ai u shpreh se "Klodiani nuk është vetëm i imi, por i gjithë Dibrës dhe i mbarë popullit shqiptar".

Në emër të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, të pranishmit u përshëndetën nga komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, i cili theksoi se: "Ndjehemi të privilegjuar që kjo shkollë do mbajë emrin e heroit tonë Klodian Tanushi.



KM e angazhuar në operacione në ndihmë të komunitetit në zonat e përmytura në qarkun Shkodër, Lezhë, Dibër

Efektivët e strukturave të Komandës Mbështetëse, kryesisht reparti ushtarak nr. 4040 (Batalioni Xhenios), janë angazhuar në kryerjen e rikonicionit për funksionimin e urës në fshatin Manati të Lezhës, zonë e cila është izoluar për shkak të dëmtimit të urës.

Në fshatin Rukaj, bashkia Mat, është bërë e mundur ngritja e një çadre në mbështetje të një familjeje, pasi banesa e të cilëve është dëmtuar nga tërmeti.

Operacion për transportim dhe shpërndarje ndihmash në qarkun Dibër në bashkitë Mat, Klos, Bulqizë dhe Peshkopi, në zonat e izoluar nga reshjet e dëborës.

Gjithashtu, është vendosur në gatishmëri DMR, Kukës si dhe një efektiv prej 30 vetash të BMEC për t'i ardhur në ndihmë autoriteteve lokale në Kosovë, në ndihmë të popullsisë e cila ka pësuar përmytje nga kushtet e këqija atmosferike.



Batalioni i Tretë i Këmbësorisë, mirëpret kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit (KTHOSH). Gjatë prezantimit të punës së tyre, risollën në vëmendje rëndësinë e këtij batalioni dhe ushtrimin me profesionalizëm të detyrave të caktuara.



Zhvillohet Stërvitja Individuale Bazë (SIB) dhe SIA

Stërvitja Individuale Bazë (SIB) dhe ajo e Avancuar (SIA), dy stërvitjet fillestare për çdo ushtar, edhe këtë fillim vitit, vijojnë të zhvillohen me profesionalizëm nga instruktorët e Batalionit të Parë dhe atij të Tretë të Këmbësorisë.



Në ambientet e Auditoriumit të Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e përfundimit dhe certifikimit të Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit, pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë. Në këtë ceremoni morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneral brigade Arben Kingji, komandantë forcash dhe të njëjve autonome të FA-së, drejtorë të Shtabit të Përgjithshëm, atashet e Republikës së Kosovës i akredituar në Shqipëri, nënkolonel Enver Hoti, staf akademik dhe mbështetës si dhe pedagogë dhe kursantë.

Ceremonia u hap me fjalën e rastit të zëvendëskomandantit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel Emëror Hajdarasi, i cili ndër të tjera theksoi se: "Kursi që sapo përfunduar përbën një ngjarje të shënuar në karrierën tuaj ushtarake. Qëllimi i tij ishte përgatitja dhe kualifikimi juaj për pozicione të ndryshme të shtabeve të reparteve, si dhe në shtabe të reparteve e nënreparteve shumëkombëshe të strukturave të NATO-s. I lumtur që në kurset institucionale që zhvillohen pranë Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë marrin pjesë dhe do të vazhdojnë në vijim dhe përfaqësues nga Forca e Sigurisë së Kosovës, duke sjellë eksperiencat dhe përvojat më të mira. Për tre muaj të kohëzgjatjes së këtij kursi, ju kuptuat më mirë mënyrën se si shtabi kryen misionin e tij, jeni bërë më të aftë në përmbushjen e kërkesave të drejtim komandimit dhe të stërvitjes. Ju përmbushët qëllimin e kursit me njohuritë e fituara gjatë zhvillimit të kurrikulës mësimore dhe tani do të ndiheni më komod në realizimin e detyrave tuaja si oficerë shtabi në nivel batalioni". Në përfundim të fjalës së tij ai falënderoi kursantët për korrektesinë, përkushtimin dhe profesionalizmin e treguar në realizimin e programit, stërvitjes dhe vizitave të zhvilluara në njësitë e Forcave tona të Armatosura.

Në vijim, në emër të kursantëve përshëndeti kapiten Zaje Osma, e cila uroi kolegët për përfundimin me sukses të kursit, duke u shprehur: "Gjatë kësaj periudhe, kuptuam se të qenit pjesë e këtyre auditorëve kërkon shumë përpjekje dhe përkushtim, për të përvetësuar e asimiluar programin arsimor me rezultate sa më të larta, me qëllim përparimin në gradë dhe vijimin me sukses të karrierës tonë ushtarake". Në fjalën e saj ajo falënderoi pedagogun përgjegjës, stafin akademik dhe zëvendëskomandantin e kolegjit për të gjithë mbështetjen e vëmendjen gjatë procesit mësimor, duke e bërë më të lehtë zhvillimin e kursit.

Më pas përshëndeti shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Arben Kingji, i cili pas falënderimit për përfundimin me suksese të kursit veçoi se mjedisi i sigurisë sot kërkon ndryshim të shpejtë të vendimmarrjeve, prandaj duhet punuar fort për plotësimin e kurrikulës mësimore me informacionet më të fundit. Më tej gjeneral brigade Kingji do vijonte: "Me mbarimin e këtij kursi ju jeni në gjendje të organizoni nesër punën tuaj si lidership, në shtab apo në përfaqësi të ndryshme jashtë Republikës së Shqipërisë. Ju siguroj se bashkëpunimet me Forcat e Sigurisë së Kosovës do të jenë të vazhdueshme dhe në qendër të vëmendjes tonë."

Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave dhe me fotografi të përbashkët me kursantët, stafin akademik, shefin e Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, komandantë e drejtorë.



Përfundon Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit



Kursi Themelor i Oficerit të Shtabit viziton kantierin detar në Pashaliman

Në vijim të realizimit të programit mësimor, kursantët e Kursit Themelor të Oficerit të Shtabit të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë zhvilluan një vizitë njohëse në kantierin e Pashalimanit në qytetin e Vlorës.

Stafi akademik dhe grupi mësimor u prit nga kapiten i rangut të parë, Engjëll Sinanaj, komandanti i Flotiljes dhe kapiten i rangut të tretë Ilirjan Kristo, zëvendëskomandanti i Qendrës së Zhytjes, të cilët mbajtën brifingje informuese mbi historikun, misionin, detyrat dhe të gjithë spektrin e aktivitetit të njësisë. Në prezantime u evidentua edhe kontributi që jep ky repart në pjesëmarrjet në operacione brenda dhe jashtë vendit, emergjencat, punën që bën për rritjen e nivelit të operacionalitetit, modernizimit dhe përmirësimeve në infrastrukturë. Kursantët treguan interes dhe drejtuan pyetje për kapacitetet operacionale, kontrollin dhe monitorimin e trafikut detar, zbatimin e ligjshmërisë, mbrojtjen e mjedisit detar si dhe për rritjen e ndërveprueshmërisë në kuadër të operacioneve me strukturat homologe të vendeve partnere të NATO-s, për përballimin e emergjencave të ndryshme në hapësirat adriatiko-joniane.

Më pas me kursantët u zhvillua një tur njohës në ambientet e bazës për të parë nga afër infrastrukturën, organizimin e ruajtjes, armatimin, pajisjet dhe shërbimin e mirëmbajtjes së mjeteve detare. Më interes ishte dhe vizita në anijet e klasit "Iliria", ku kursantët u njohën me aparaturat, sistemet e lundrimit për realizimin e misioneve të ndryshme civile dhe ushtarake. Kjo vizitë zgjeroi akoma më shumë njohuritë e kursantëve mbi misionin, detyrat dhe përgjegjësitë e Forcës Detare.



Roja Bregdetare është njoftuar nga QNOD për situatën e vështirë në të cilën ndodhej anija e peshkimit tip “flug” me emrin “Makaj 0624”, me 3 persona në bord, e cila ka pësuar avari në sistemin elektrik të motorit dhe nuk mund të lundronte.

Mjeti lundruar i ndodhur në rrezik ka kërkuar ndihmë. Menjëherë pas marrjes së informacionit, Roja Bregdetare organizoi operacionin duke i dhënë ndihmë të menjëhershme personave në bord.

Mjeti u identifikua në distancën 22 milje në veri të ishullit të Sazanit, nga anija P-116 e Forcës Detare, e cila i dha ndihmë menjëherë mjetit të rimorkiuar në drejtim të Triportit në Vlorë.

Operacion SAR nga efektiv i anijes P-116 “Bora”



Ekuipazhi i Forcës Detare i vjen në ndihmë anijes tregtare të përfshirë nga flakët e zjarrit

Siguria Portuale Durrës ka njoftuar se një anije tregtare që ndodhet në radën e Durrësit ka prezencë tymi (zjarri). Menjëherë u njoftua Komanda e Forcës Detare dhe QBO, pas njoftimit të menjëhershëm anijes P - 04 “Semani”, iu dha kushtrim për dalje në rajon, monitorim, raportim dhe asistence, si dhe anijes

P-133 “Lissus” për dalje në det, asistencë dhe dhënie ndihme për fikjen e zjarrit në anijen tregtare. Anija në avari është tregtarja me emër “Kledes Mary” me flamur të Panamasë, e cila ka pësuar zjarr në një lokal poshtë urës së komandimit.

Forca Detare ka të angazhuar në operacion dy anije P-133 “Lissus” dhe P-04 “Semani”. Gjithashtu ndodheshin mjete nga PKM, Siguria Portuale Kapitaneria. Situata e zjarrit u vendos nën kontroll, duke ardhur në ndihmë në kohën e duhur.



Operacion SAR nga efektiv i anijes P - 04 “Semani”



Ekuipazhi i anijes P - 04 “Semani” pasi mori njoftimin se një flugë peshkimi kishte pësuar avari, shkoi për t'i ardhur në ndihmë. Fluga e peshkimit “Makaj” me tre persona në bord, në distancë rreth 4,7 milje në jugperëndim të Kepit të Rodonit, po shtyej nga era për në det të hapur.

Po këtij mjeti i është dhënë ndihmë, më datë 12 janar 2023, në zonën e derdhjes së Vjosës nga Anija P-116, e cila e ka rimorkiuar dhe dërguar në Triport.

Efektiv i anijes P - 04, i Forcës Detare, i ka ardhur në ndihmë në kohën e duhur dhe realizoi rimorkimin për në Portin e Durrësit.

58 vjet nga lundrimi i parë i anijeve luftarake nga ishulli i Sazanit për në Bazën Detare të Durrësit

Nga fundi i vitit 1964, Këshilli i Mbrojtjes i asaj kohe vendosi ristrukturimin e FLD-së, e cila deri në atë kohë ishte e centralizuar, me vendbazim ishulli Sazan. Kështu u vendos që anijet mbiujëse luftarake të ndahen e të krijohen Flotila e Durrësit dhe Flotila e Vlorës.

Si kriter bazë i caktimit të kuadrove do të merrej vendbanimi Durrës, dhe kjo për efekte strehimi. Në përbërje të Flotiljes Durrës u caktuan anije minahëqëse, gjuajtëse kundër ND si dhe anije ndihmuese. Komandant ishte caktuar Dashamir Ohri. Ai vinte nga një përvojë e pasur si ish-komandanti i bazës së nëndetëseve të Pashalimanit, pikërisht në periudhën kur ishte krijuar konflikti i madh me aleatin e atëhershëm, Bashkimin Sovjetik. Ai është dhe një nga 17 oficerët e parë shqiptarë që ka mbaruar studimet në vitin 1947 në ish-Jugosllavi. Dashamir Ohri ka qenë komandanti i nëndetësës së parë shqiptare, të ardhur me një katërshe nga Bashkimi Sovjetik.

Vitin e ri 1965 e festuam së bashku në Sazan

Në mesditën e 4 janarit 1965, kapiten i Rangut III-të D. Ohri, i emëruar komandant i Flotiljes Durrës, organizon një takim me kuadrot e Shtabit të Flotiljes dhe komandantët e anijeve; i njeh me planin e lundrimit të Flotiljes nga Sazani në Durrës. Rreth orës 20:00 fillon dalja e anijeve nga Sazani. Ky moment ishte shumë prekës. Dalja e anijeve u shoqërua me rënien e sirenave si përshëndetje tradicionale e FLD-së. Lundrimi për në Durrës u bë natën, në formacion lundrimi dhe në kushtet e një deti të trazuar.

Në mëngjesin e datës 05 janar 1965, anijet mbërritën në Radin e Durrësit, e më pas u akostuan në Kallatën Lindore të Portit Detar Durrës. Kështu data 5 janar 1965 shënon ditën e rikrijimit të Bazës Detare Durrës. Para komandës e shtabit të Flotiljes dëlin detyra për konsolidimin e vendbazimit. Nisi gjithçka nga e para sepse mungonte infrastruktura, si bankinat, godina e komandës, kushtet e përgatitjes speciale, depot, baza materiale për përgatitjen e efektivave etj.

Në sajë të punës vetëmohuese të kuadrove dhe efektivave, u arrit që të ndërtohej bankina e silurë-hedhëseve, ofiçina e silurëve si domosdoshmëri për anijet që pritej të vinin në vitin 1965 nga RP e Kinës. Ndihmesë të madhe për sigurimin e kushteve të vendba-



zimit dhanë edhe ndërmarrjet e qytetit të Durrësit si NN Porti, Porti Detar etj.

Rruga në të cilën ka ecur Baza Detare e Durrësit gjatë këtyre viteve ka qenë e mbushur me sakrificë në kryerjen e detyrave për mbrojtjen e ujërave tona territoriale nga veprimtaritë e paligjshme të anijeve të huaja, ndalimin e tentativave për kontrabandë etj.

Në vite, Bazës iu shtuan anije të tjera si silurë-hedhëse, gjuajtës detar; u ndërtuan vendbazimi në B. Pallë, ofiçina të riparimit të anijeve, godinat e komandës, shkolla e përgatitjes së efektivave etj.

Janë të shumtë ish-detarët që kanë kryer shërbimin ushtarak në Bazën e Durrësit që punojnë në profesione të ndryshme në Flotën Tregtare, në Flotën e Peshkimit etj. Në këtë 58-vjetor të rikrijimit të Bazës Detare të Durrësit, për punën plot përkushtim në shërbim të atdheut kujtojmë me nderim e respekt kuadrot e para që hodhën themelet e rikrijimit dhe konsolidimit të Bazës, të cilët janë ndarë nga jeta, si: komandantët e Bazës në vite kapiten rangut III D. Ohri, kapiten i rangut I M. Plani, shefi i Shtabit të Bazës, kapiten i rangut III M. Lulollari, komandantët e skuadriljeve silurë-hedhëse, kapiten i rangut III Selam Qejvani, kapiten i rangut III Ali Canosinaj, komandantin e grupit të anijeve mbiujëse Petro Treni, Inxhinierë, mekanikët Piro Tushi, Ismet Beluli, Sami Shyti, Mark Berdufi, M. Hysi; kuadrot me përvojë Xh. Bujari, Vasil Petro, Spiro Kote, A. Sevrani, B. Demko, Mihallaq Papadhopulli, B. Shehu, T. Gërveni, Skënder Sulku, Halit Hima, Thoma Rubia, B. Këlmendi, S. Beluli, I. Rexha etj., si dhe Tësim Sinani, Hektor Meçe, A. Daja, D. Hoxha, që u larguan

nga jeta shumë para kohe. Le t'u shërbejë përvoja e tyre brezave të kuadrove të rinj të Bazës Detare të Durrësit.

Me ndryshimin e sistemit politik në vitin 1990, Baza detare e Durrësit pësoi ndryshimet e veta në konceptin e detyrave, organizim dhe strukturë. Si rezultat i hapjes me botën, në ujërat tona u rrit intensiteti i lëvizjeve të anijeve të huaja për qëllime ekonomike, turistike e kontrabande. Për rrjedhojë u rrit edhe mundësia e shkeljeve të ujërave tona; u shtua veprimtaria për peshkim të paligjshëm, përpjekja për trafik të klandestinëve, të drogës, të armëve etj. Baza Detare e Durrësit i ka përballuar të gjitha detyrat në ndalimin e këtyre veprimtarive të paligjshme. Në këtë aspekt kontribut ka dhënë edhe bashkëveprimi me anijet e Flotave Ushtarake të NATO-s. Vlen të përmenden veprimtaritë e përbashkëta të mjeteve të Bazës Detare të Durrësit për embargo ndaj ish-Jugosllavisë, duke ndaluar misionet kontrabande, anije naftëmbajtëse etj. Në të gjitha stërvitjet e përbashkëta, kuadrot tona kanë treguar përgatitje profesionale, kanë qenë në të njëjtin nivel me kuadrot e flotave të huaja partnere. Rol të rëndësishëm në zbatimin e detyrave kanë luajtur sistemi i vëzhgimit detar nëpërmjet PRT të vendosura në vendet e studiara për këtë qëllim, të cilat janë pajisur me teknikë bashkëkohore. Tashmë anijet me të cilat u rikrijua Baza Detare kanë dalë jashtë strukturës së Flotës dhe vendin e tyre e kanë zënë anije të reja të ardhura nga vendet aleate si SHBA-të, Holanda, Italia etj., të cilat i përgjigjen plotësisht kryerjes së detyrave të ruajtjes së ujërave tona territoriale.

Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, vepra dhe emri i të cilit do të shndërrohej në legjendë, do t'i përkiste përjetësisë, siç ishte dhe mbeti të gjallët e tij nga më të zëshmit kushtrime të ekzistencës sonë në histori.

Ishte 17 janari i vitit 1468, kryezoti i Arbërisë ndërroi jetë në moshën 63-vjeçare në vitin e 24 të mbretërimit.

"Mblidhuni, mblidhuni të gjithë o princër e sundimtarë arbëror.

Sot u bënë copë dyert e Epirit dhe Maqedonisë, sot u rrëzuan muret dhe fortesat tona, sot fluturoi tërë forca dhe fuqia jonë, sot u përmbysën fronet dhe pushtetet tona, sot u shua krejt së bashku me këtë njeri çdo shpresë e jona", i tha këto fjalë Lekë Dukagjini me të dhënë lajmin për vdekjen e Skënderbeut.

Trupi i tij u varros në kishën e Shën Kollit në Liss (Lezhë). Ceremonia e lamtumirës ishte e denjë për një mbret. Erdhën nga çdo kënd i botës të dërguar dhe ngushëllime që paqësonin plagën e kësaj humbjeje të rëndë që kishte pësuar Arbëria.

Gjithashtu, gjatë kohës që Skënderbeu po jepte grahamat e fundit të jetës, kali, të cilin e shalonte kur e kishte për t'u përleshur, u bë aq shumë i egër, i tërbuar dhe i pafrenueshëm, sa që s'donte të mbante më njeri mbi shpinë dhe pas pak mbaroi edhe ai.

Historia e Skënderbeut është themeli i të gjithë historive, të cilat tregojnë shtegun ku ka kaluar populli ynë.

Udhën e gjatë të qëndresës dhe qytetërimit, rrugëtim i cili është i shtruar me sakrificat më sublime dhe blatimet më të shenjta. Figura e Heroit Tonë Kom-



555-vjetori i përjetësimit të krenarisë kombëtare, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu

bëtar, Gjergj Kastrioti - Skënderbeu është një nga më madhështoret e gjithë asaj rrëfenje që ka ardhur deri në ditët tona. Nuk kishte më të lavdishme deri atëherë.

E tillë është historia e këtij zemërluani, mendjendrituri dhe strategu të shquar të artit të

luftës. Të tilla janë bëmat dhe trimëritë, urtësitë dhe gjenialitetet e zgjidhjeve vendimtare për fatin e luftës dhe lirisë. Ai ka kapluar kufijtë e legjendës, sepse e këtyre përmasave ishte ardhja e tij.

Krenarë ndër breza për këtë figurë legjendare.

104 vjet më parë,
më 24 janar
1919, kaloi në
përjetësi për të

hyrë dhe qëndruar në altarën e pavdekshmërisë së kujtesës sonë kombëtare, personaliteti më i shquar shtetëror, diplomatik dhe shoqëror i lëvizjes kombëtare shqiptare, Babai i Pavarësisë, Themeluesi i shtetit shqiptar dhe figura më e dashur e karizmatike e shqiptarëve, Ismail Qemal Vlorë. Ismail Qemal Vlorë lindi më 24 janar 1844, në Vlorë në familjen e madhe të Vlorajve. Mbiemri i tij Vlorë flet shumë për vendlindjen e tij, për qytetin, familjen e tij patriotike, formimin dhe atdhedashurinë. Familja "Vlorë" është ajo familje e madhe që në breznitë e saj i ka nxjerrë shumë personalitete, me pikën kulmore: Themeluesin e shtetit shqiptar, Ismail Qemal Vlorën, që i kushtoi jetën dhe pasurinë idealit kombëtar. Në vitet e kryengritjeve shqiptare 1910-1912 dhe të Luftërave Ballkanike, veprimtaria atdhetare e Ismail Qemalit u kurorëzua, më 28 nëntor 1912, me shpalljen në Vlorë të Pavarësisë së Shqipërisë. Kuvendi Kombëtar i Vlorës, të cilin ai e ideoi dhe e drejtoi, e zgjodhi Ismail Qemal Vlorën, kryetar të Qeverisë së Përkohshme dhe Ministër të Jashtëm. Politikan, konsekuent i bindjeve të tij liberale dhe tejet përparimtare, të cilat buronin nga shkollimi i tij, njohuritë e gjera që zotëronte për Evropën Perëndimore, njohjen e organizimit shtetëror, sistemit ekonomik, filozofisë politike dhe qytetërimit evropian; si edhe kultura e tij e jashtëzakonshme politike e historike. Biografia dhe veprimtaria e tij politike e diplomatike janë të mahnitshme. Në gati gjysmëshekulli (1860-1908) të veprimtarisë së tij politike e shtetare në Perandorinë Osmane, Ismail Qemali shkëlqeu me të gjithë bagazhin e tij si mendimtar, politikan dhe dijetar. Megjithatë politikan e diplomat në një Perandori, në të cilën sundonte despotizmi oriental, me bindje e me sjellje ai ishte dhe mbeti demokrat liberal. Marrëveshja ishte mjeti i tij politik. Toleranca ishte mënyra e sjelljes së tij, humanizmi ishte etika e tij. Liberalizmi ishte koncepti i tij për shtetin dhe shoqërinë. Mbrojtës i të drejtave të njeriut, që ushtronte pushtetin si pushtet të ndërgjegjes. Ismail Qemal Vlorë ishte një politikan e Burrë Shteti me bindje liberale. Liberalizmi i Ismail Qemalit pati më shumë se një burim. Burimi i parë ishte shkollimi i tij. Në gjimnazin e njohur "Zosimea" të Janinës ai mësoi "...të jetojë – siç thotë vetë – në frymën e lirive të botës së vjetër greke". Aty ai u njoh dhe përvetësoi idetë liberale të Volterit, Zhan-Zhak Rusosë dhe Xhon Lok-ut. Burimi i dytë ishin njohuritë e gjera që zotëronte për Evropën Perëndimore. Ai qëndroi shpesh, diku më shkurt apo diku më gjatë, në Angli, në Francë e

104 vjet nga vdekja e "Atit të Pavarësisë", Ismail Qemali



në Itali, ku njohu organizimin shtetëror, sistemin ekonomik, filozofinë politike dhe qytetërimin e këtyre vendeve. Burimin e tretë të liberalizmit të Ismail Qemalit e përfaqëson kultura e tij e jashtëzakonshme politike dhe historike. Ai e dinte se vetëm shtetet demokratike janë shtete historikisht të qëndrueshme. Ai theksonte se "shovinizmi shtetëror, politik, kombëtar dhe fetar është varrtar i shteteve. Çdo perandori e krijuar me shpatë në të njëjtën kohë ka mbjellë edhe farën e shkatërrimit të vet". Për këtë arsye, për rregullimin shtetëror ai e çmonte "forcën morale më të fuqishme se forcën e armatosur" por, natyrisht, forcën morale të mbështetur në ligje demokratike. Gjykimi i tij i qartë, ndershmëria dhe qëndrueshmëria, sjellja e përmbajtur dhe kuraja e gjykimit e bënë sipëror dhe magjepsës personalitetin e tij. Ismail Qemali ishte zotëruesi i situatave dhe zotëri i kohës në të cilën jetoi. Po në sajë të cilësive të mësipërme dhe të një vizioni sa patriotik aq edhe largpamës, Ismail Qemali arriti të bëhet prijës i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, themelues i shtetit shqiptar dhe kryeministër i Shqipërisë.

Pa diskutim që kryevepra e tij ngelet themelimi i shtetit shqiptar

Ismail Qemal Vlorë kurrë nuk do t'i keqpërdorte ndjenjat kombëtare për qëllime politike dhe bëri atë që pakkush mund ta bënte: Shpalli Pavarësinë dhe u bë Themeluesi i shtetit të parë shqiptar. Megjithatë ishte shtet ende pa kufij, pa forca të rendit, pa ushtri, pa administratë kombëtare, pa ekonomi, pa financa; pra, shtet pa kushte shteti; Shqipëria e porsakrijuar kishte një ga-

ranci të madhe: dinjitetin politik, juridik dhe moral të shtetit, të mishëruar në personalitetin e Tij. Ismail Qemal Vlorë është politikani që e ka dashur aq shumë Shqipërinë, është politikani i ndershëm e idealist, por i braktisur nga bashkëpunëtorët arrivistë, i pa kuptuar nga një pjesë e madhe e bashkëkombësve, i përfolur e i akuzuar rrejtshëm nga intrigantë. Ismail Qemal Vlorë është i pari politikan shqiptar, që vuri mbi egoizmin Shqipërinë, që mbi keqkuptimin vuri mirësinë, tolerancën e dashurinë; themeloi debatin publik dhe institucionin e dorëheqjes edhe pse nuk meritonte të dorëhiqej. Emri i Ismail Qemalit është shkruar me germa të arta në kujtesën tonë kolektive, si Babai i Pavarësisë dhe Themeluesi i shtetit shqiptar. Ai është protagonist kryesor që bëri përpjekje kolosale politike dhe diplomatike nëpër kancelaritë e Evropës, për të siguruar mbështetjen për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Qeveria e Përkohshme, me në krye Ismail Qemalin, liberalin që ishte i bindur se virtytet shpirtërore duhet të ishin arma kryesore e saj, bëri mrekullinë. Bëri çmos që Shqipëria të shtrihej deri atje deri ku ishin kufijtë e saj etnikë. Edhe pse kjo nuk ndodhi, edhe pse gjysma e kombit ngeli jashtë kufijve të shtetit të porsaformuar shqiptar; historia ishte shkruar tashmë. Në Perugi, më 24 janar 1919, Plaku i Urtë ndërron jetë (dyshohet i helmuar), në pritje të bisedimeve me qeverinë italiane, për të mbrojtur kufijtë e Shqipërisë. Me rastin e vdekjes së tij, patrioti Mihal Grameno shkroi artikullin shumë prekës po dhe me plot optimizëm: "Mos qani!". Midis të tjerash ai shkruante: "Mos qani dhe mos vajtoni kurrë të kurrës ju o male dhe kodra të Shqipërisë! Ismail Qemali, Plaku i Shqipërisë, nuk ka vdekur dhe kurrë nuk mund të vdesë sa të jetë bota. Në është që ka vdekur Skënderbeu, atëherë le të themi që vdiq edhe Plaku, po jo kurrë! Plaku rron dhe do të rrojë sa të ketë Shqipëria shqiptarë. Mos qani pra ju, o shqiptarë, se rron Plaku, posa që kemi për të gjurmuar Program të tij kombëtarë dhe ay program qëndron: Shqipëria e shqiptarëve! Mos qani pra mos qani!" Te Ismail Qemali bashkohen në një: Njeriu, Shtetari, Pavdekësia! Emri i Ismail Qemal Vlorës në historinë e popullit shqiptar mbetet përgjithmonë i shënuar si Ati i Kombit, si demokrati liberal, që filloi qeverisjen demokratike në jetën kombëtare dhe si personaliteti që dhuntitë e tij politike i përdori në mënyrat më të denja për punët më të rëndësishme të kombit të tij.

INTERVISTË ME KOLONEL (R) THOMA KONDURI

Shekullimi i Armës së Artilerisë, vlerë e shtuar e FA-së

INTERVISTOI
SHEFE E SEKTORIT TË BOTIMEVE,
ANJEZA MUSOLLARI

Për më shumë se një shekull jetë Arma e Artilerisë feston krijimin e saj, se si ka udhëtuar nëpër furtuna, për të qenë e fortë në mbrojtje të atdheut si dhe transformimet e saj ndër vite, për shtypin ushtarak vjen një prej drejtuesve të saj, z. Thoma Konduri, i cili prej vitesh drejton Shoqatën Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, është një nga ushtarakët madhorë të vendit, njëkohësisht një intelektual që nuk ka reshtur të punojë me përgjegjësi e përkushtim dhe në fusha të tjera në interes të shoqërisë dhe vendit.

Kolonel (R) Thoma Konduri ka pasur një karrierë të ndritur ushtarake si, komandant i Baterisë së Drejtimit të Artilerisë Br18K-Peshkopi, shef i Zbulimit të Artilerisë Br18K, shef i Artilerisë b5k Mustafaj-Peshkopi, komandant i Baterisë së Lartësisë-Gjuras-Peshkopi, instruktor i Artilerisë në Shkollën e Oficerëve Rezervistë të K7K-Burrel, shef Operativ i Degës së Artilerisë në K7K-Burrel, zëvendësshef i Degës së Artilerisë në K7K-Burrel, nënkryetar i Këshillit Shkencor të K7K, komandant i Br7AT-Burrel (1983-1985 në Bulqizë), komandant i Br1AT-Tiranë.

Për shkak të reformës, shef Personeli i BrK (Rep. 5715-Tiranë), kom. GrA (BrK-Universitetit-Tiranë), koordinator i Artilerisë në DK-Tiranë, ndihmës i zëvendësshefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë për Artilerinë (Drejtor i Artilerisë).

I vlerësuar për punën e tij me dekoratat: Medaljen e Shërbimit Ushtarak, Urdhri "Ylli i Kuq" i Klasit të III, Urdhri i Shërbimit Ushtarak i Klasit I.

Kur daton Arma e Artilerisë?

Armët kolektive të zjarrit, balistat, bombardelat, bombardat, paraardhëset e artilerisë, në trevat apo principatat shqiptare, u shfaqën në shekullin XIV (rreth vitit 1380), për mbrojtjen e kështjellave apo ndalimin e hyrjes së sulmuesve në rrugëkalime apo lugina të ngushta. Kjo armë ka ndjekur rrugën dhe shkallën e zhvillimit të ushtrive që i përdornin ato. Kështu ajo



mori zhvillim cilësor dhe sasior në kohën e Skënderbeut. Artileria e asaj kohe, gjeti përdorim gati në çdo betejë. Ushtria e Skënderbeut kishte në përdorim artileri të rëndë, të marrë kryesisht nga Venediku dhe Napoli, që e përdorte kryesisht për mbrojtjen e kështjellave, me gjyle kryesisht prej guri të rrumbullakosur si dhe artileri të lehtë (bombardela dhe bombarde) që e përdorte në veprime sulmuese apo prita, me gjyle prej plumbi apo

bronzi, shumica e të cilave të përgatitura në fonderitë e tija. Larghedhja e tyre nuk ishte më e madhe se 200-300m. Kjo artileri nga rrethimi në rrethim dhe nga beteja në betejë, rritej e perfeksionohej në përdorim. Sasia e disponueshme nuk figuron në asnjë dokument të njohur.

Dokumente më të plota ka për përdorimin e artilerisë nga ushtria e Ali Pashë Tepelenës, i cili dallon ndjeshëm nga bashkëkohësit e tij Bushatlli, si nga ana organizative, sasiore dhe teknologjike. Artileria në pashallëkun e Aliut arrinte deri në 500 topa të kalibrave dhe prodhimeve të ndryshme. Këto ai i siguronte nga Venediku, Italia apo Franca por edhe nga fonderia e tij, që ai kishte ngritur në Janinë për këtë qëllim. Në vitin 1798, Aliu hapi Shkollën e Artilerisë, drejtor të së cilës vuri kolonelin francez, Sharbonel.

Shpallja e pavarësisë, më vitin 1912, u realizua në një situatë tepër kaotike në Ballkan. Perandoria Otomane po përmbysej. Mbretëritë ballkanike shpalosën interesat shoviniste të tyre dhe filluan luftën ballkanike. Megjithëse qeveria e brishtë e Ismail Qemalit nuk ishte në gjendje të organizonte përballjen me këto fuqi, ishte fryma patriotike e popullit që gjente forcë të organizohej e të përballej me pushtuesit si në veri ashtu edhe në jug të vendit. Shumë vullnetarë së bashku me disa reparte të mbetura të ushtrisë otomane, në përbërje me shumicë shqiptare, organizuan rezistencën në disa zona të sulmuar nga serbët, malazezët apo grekët. Kështu vetëm dy muaj pas shpalljes të pavarësisë, më 6-7 shkurt 1913, në Bërdicë të Shkodrës forcat serbe u shpartalluan keqas nga vullnetarët shqiptarë. Në këtë betejë u përdorën masivisht 11 topa të mbetur nga ushtria turke. Serbët lanë rreth 2000 të vrarë dhe 300 robër. Historia serbo-malazeze e asaj kohe e ka quajtur atë betejë "Kasaphana e Bërdicës". Po ashtu në Kryengritjen e Dibrës kundër Serbisë, realizuar në trevat e Dibrës, Ohrit, Strugës, Gostivarit dhe Tetovës, në periudhën gusht-shtator 1913, kryengritësit kapën dhe përdorën me sukses kundër pushtuesit 24 topa.

Në Luftën e Vlorës, vetëm në fazën e parë të saj më 5 deri më 10 qershor 1920, nga luftëtarët shqiptarë u kapën 11 topa, të cilët u përdorën me sukses kundër italianëve, në fazën tjetër të luftës.

Ishte qeveria që doli nga Kongresi i Lushnjës që, më 17 janar 1921, vendosi Armën e Artilerisë në strukturën e Ushtrisë.

Cili ishte komandanti i parë i baterisë?

Komandant i Baterisë së parë u emërua kapiten Rexhep Mitrovica, pjesëmarrës në luftë kundër serbëve. Ai kish mbaruar Universitetin e Stambollit për Inxhinieri Mekanike si dhe dy vjet Shkollën e Plotësimit të Artilerisë.

Të gjitha qeveritë e mëvonshme, krahas riorganizimit dhe pajisjes së ushtrisë, punonin edhe për kompletimin e asaj ushtrie me artilerinë e nevojshme dhe të kohës.

Kur u hap Shkolla e Artilerisë?

Më 15 nëntor 1928, në Tiranë u hap Shkolla e Artilerisë për përgatitjen e oficerëve të nivelit togë e bateri. Pas kësaj, në vazhdim, u hapën e funksionuan deri në vitin



**Nënshkrimi i marrëveshjes së bashkëpunimit
trepalësh MM-SHP i FA-SHKURSH 2019**

1938, kurse 6-mujore për përgatitjen e nënoficerëve dhe specialiteteve të artilerisë. Rol në rritjen e cilësisë të strukturës të artilerisë, luajti shkollimi dhe titullimi i shumë oficerëve në Akademitë e Italisë.

Në prag të pushtimit fashist, Ushtria Kombëtare kishte 22 bateri (6 grupe) artilerie, 1 bateri bregdetare dhe 1 grup KA 20m/m (12 gr. zj.). Kjo artileri për cilësinë dhe sasinë i përshtatej kohës dhe nevojave të ushtrisë. Por drejtimi i strukturave dhe i personelit të kësaj artilerie ishte nën komandën e ushtarakëve italianë të atashuar apo emëruar në ushtrinë shqiptare.

Në ditën e 7 prillit 1939, kur edhe artileria duhej përdorur kundër pushtuesit, ajo u tradhtua dhe u sabotua. U tradhtuan nga drejtuesit, që nga mbreti e deri te komandantët e thjeshtë. U sabotuan sepse topave u ishin hequr shulat. Nga këto elementë shpëtuan dy bateri, ajo e Durrësit e vendosur tek Kodra e Mojsiut dhe një bateri që erdhi nga Tirana, ngarkuar mbi makina, e komanduar nga Kapiten Gaqo Mosko, e cila u pozicionua pranë detit, diku tek Ura e Dalanit. Të dy bateritë, në mënyrë të pavarur, hapën zjarr mbi anijet në det, por edhe në forcat italiane në port ku po zbarkonin. Artileria e anijeve iu kundërpërgjigj shumë më fuqishëm. Ajo i neutralizoi të dy bateritë. Baterisë së Durrësit, iu vranë dy ushtarë dhe iu shkatërrua një top, ndërsa baterisë së Tiranës iu plagosën dy ushtarë.

Pse 18 tetori kremtohet si "Dita e Artilerisë"?

Rezistenca e armatosur e popullit kundër fashizmit filloi në vitin 1942, kur u ngritën çetat e para partizane të armatosura. Përdorimi i artilerisë, kundër pushtuesit, në këtë luftë, filloi kur forcat partizane u organizuan në brigada dhe kishin superioritet në disa përpjekje. Atëherë mundësohej edhe rrëmbimi i këtyre armëve. Më i gjerë ishte përdorimi pas kapitullimit të Italisë,

kundër pushtuesit gjerman, me topat e marrë italianëve. Struktura organike e artilerisë në brigadat partizane nuk ishte e njëlojtë. Ajo varej nga mundësitë materiale dhe njerëzore, terreni dhe detyrat. Por si rregull u vendos që minimalisht, çdo BrS të kishte një bateri artilerie, kryesisht të transportueshme me kafshë.

Aksioni simbolik, politik i artilerisë partizane, ishte ai i baterisë të artilerisë të Br3S, e cila nga kodrat e Saukut, në ora 9.00, të datës 18 tetor 1943, goditi me 20-30 predha Asamblenë Kushtetuese, të emëruar dhe mbledhur nga pushtuesi gjerman në pallatin e Viktor Emanuelit (sot Pallati i Brigadave). Ky aksion, në atë kohë, bëri jehonë shumë të madhe në popull dhe në radhët e luftëtarëve. Kjo ditë, gati për 60 vjet, u quajt, u caktua dhe u kremtua si "Dita e Artilerisë".

Në fund të luftës UNÇ-ja dispononte 586 topa, obuza dhe mortaja, 149 topa të artilerisë KA, të kapura kundërshtarit, të prodhimit italian, gjerman dhe çek.

Kur filloi procesi i ristrukturimit të Armës së Artilerisë?

Pas çlirimit të vendit filloi ristrukturimi i ushtrisë. Ajo do të kthehej në ushtri të standardeve të kohës. I njëjti proces do të ndodhte edhe me artilerinë.

Shpejt filluan të vijnë armë artilerie të kalibrave të ndryshme me municionet përkatëse. Shumë kuadro



shkuan jashtë, në shkolla të ndryshme, kryesisht në Bashkimin Sovjetik. Brenda pak viteve ndryshimet në teknikë dhe përgatitje ishin të ndjeshme. Këto arritje u provuan shumë shpejt. Në provokacionin e 2 gushtit 1949, nga ushtria greke, në rajonin e Gramozit dhe Bilishtit, artileria luajti një rol shumë të ndjeshëm dhe ndikim të dukshëm në dështimin e agresionit me humbje të ndjeshme të armikut. Shpejtësia, sasia e veprimeve dhe saktësia e zjarrit të artilerisë ishin të frikshme për forcat greke, në shumë raste degjizive për fitoren e forcave tona. Sipas thëniesve të kohës, tek forcat greke u hap fjala se "ishte artileria sovjetike ajo që qëllonte mbi ta".

Në vitin 1950 u krijua Traktati i Varshavës, si

kundërvënien e Paktit të Atlantikut të Veriut. Në atë traktat u anëtarësua edhe vendi ynë. Krijimi i dy organizatave politiko-ushtarake shënoi edhe fillimin e Luftës së Ftohtë. Të dy organizatat mbrojnë dy sisteme të ndryshme shoqërore, njëri diktaturën dhe tjetri demokracinë. Të dy ruajnë njëri-tjetrin. Filloi gara e armatimit. Shqipëria, si vend i vogël, i varfër, i ndarë gjeografikisht, pa kufij shtetëror nga vendet e Traktatit të Varshavës, do të kishte një trajtim më të veçantë nga ana ushtarake, nga anëtarët e Traktatit. Kështu ndodhi Shqipëria u armatos ndjeshëm, me avionë, anije mbi dhe nënujësë, tanke, në këtë kuadër edhe me artileri tokësore, bregdetare dhe kundërajrore. Reparte e njësi të reja shtoheshin. Nga tre KK u bënë pesë. Bateritë bregdetare ktheheshin në grupe, grupet tokësore në regjimente etj. Me qindra ishin studentët që shkonin çdo vit për studime në vendet lindore e kryesisht në BS. Ushtria bazohej kryesisht në forcat (efektivin) aktive. Stërvitjet me trupa të shoqëruara edhe me qitje të llojeve të armëve, ishin të përvitshme.

Çfarë ndodhi me Armën e Artilerisë në vitet '50-'60, kur situatat politike me vendet e bllokut po shkonin drejt prishjes?

Në fund të viteve '50 dhe në fillim të viteve '60

të shekullit të kaluar, nisën divergjencat ideologjike në kampin socialist. Në këto kushte partia shtet që qeveriste në vendin tonë, u nda nga kampi ku bënte pjesë, duke u izoluar nga e gjithë Europa. Pushtimi i Çekosllovakisë nga tanket ruse, në vitin 1968, ishte një tjetër shtysë tronditëse për t'u lidhur me RP të Kinës. Izolimi nga e gjithë Europa dhe frika nga të dy organizatat ushtarake, orientoi udhëheqjen tonë të intensifikojë lidhet me Kinën, të marrë prej saj jo vetëm ndihma ekonomike por në radhë të parë ushtarake. RP e Kinës ishte e pa kursyer në këtë drejtim.

Pas kësaj situatë në ushtrinë shqiptare filluan reforma të tjera në drejtim të shtimit të strukturave të reja si Grupimet Luftarake të nivelit të Korpunit, të shtohen Forcat Rezerviste dhe FV në Forcat e Armatosura të vendit. Në këtë kuadër artileria

u rrit shumë dhe arriti që të përbëjë rreth 30% të efektivit të Forcave Tokësore të Ushtrisë. Ajo ishte fuqia më e madhe e zjarrit e Trupave Tokësore. Argumenti bazë për t'i dhënë këtë peshë Artilerisë në raport me armët e tjera ishte fakti i pamundësisë të sigurimit të një fuqie më të madhe zjarri nga armët e tjera si Aviacioni, Flota Detare apo raketat. Mungesa e plotësimit të nevojave të zjarrit nga këto armë u llogarit që të kompensohej me shtimin numerik të Artilerisë. Kështu, Artileria e FA-së arriti të përbëhej nga 8 280 gryka zjarri, pa llogaritur 1 341 gryka zjarri të Art. KA. Sasi tepër e madhe në raport me ushtritë e tjera. Kjo artileri u strukturua në 10 Brigada AT, të cilat kishin nga 5-6 Gr. A; në 7 Rgj. të ABD me nga

4-7 bateri; në rreth 96 BrK me nga 3 Gr. A dhe në 5 brK që kishin nga 3 bateri artilerie; në 16 bateri lartësie; si dhe në Njësitë Sulmuese, Vullnetare, Zbuluese etj.

Cila ishte struktura e Artilerisë?

Struktura organizative e Artilerisë:

- Komanda e Art. (më vonë Drejt. e Art.) në MM
- Dega e Art. në KK (DK)
- Sek. i Art. në BrK
- Komanda e Gr.A në BrK ose BrA
- Shefi i Art. bk në bk
- Komanda e baterisë në Gr.A ose bk
- BrA në vartësi të MM ose të KK (DK)
- RABD në vartësi të KK (DK)

Kush ishin disa prej drejtuesve kryesorë të Artilerisë ndër vite?

Para vitit 1929, drejtuesit kanë qenë italianë.

Pas çlirimit: Gjeneral Hulusi Spahiu; Gjeneral Tahir Kadare; Gjeneral Gjin Marku; Gjeneral Todi Naço; Kol. Ferik Hado; Kol. Sul Domi; Selfo Baçi; Ferdi Toro.

Pas vitit 1990: Kol. Lulzim Bllaka; N/kol. Garip Lata; Kol. Harillaq Stoja; Kol. Thoma Konduri.

Si përgatitej kuadri i Artilerisë?

Dy detyra individuale në muaj. (Për oficerët e trupës)

Një qitje në poligonin top-pushkë në muaj.

Dy ditë mbledhje mësimore në muaj.

12 ditë mbledhje mësimore sipas specialitetit në vit.

Në qitjet vjetore: - Kontroll teorik dhe praktik në poligon top-pushkë

Oficerët e shtabeve:

- Praktikë shtabi 2 ditë në vit
- Stërvitje shtabi 3 ditë në vit
- Stërvitje komando-shtabi 3 ditë në vit.
- Mbledhje mësimore për specialitetin dhe detyrën 6 dit në vit.

Të gjithë oficerët:

Njohja me detyrën luftarake Dy herë në vit.

Drejtorja e Artilerisë një herë në 4-5 vjet zhvillonte sesion shkencor në interes të novacionit dhe rritjes cilësore të përdorimit të artilerisë, ndërsa çdo 2-3 vjet zhvillonte konkurse dhe gara artilerie. Këto zhvilloheshin edhe në Korpus apo Divizion. 1/3 e artilerisë në shkallë vendi ishte në gatishmëri të përhershme luftarake, në pozicione luftimi, në rajonin e detyrës luftarake. Këto reparte ishin të kompletuar me 30% me ushtar aktiv.

Çfarë do të thotë gatishmëri për këtë Armë dhe cilat ishin shkallët e saj?

Shkallët e gatishmërisë ishin tre:

Gatishmëria Nr. 3 ishte prezenca dhe veprimtaria e përditshme e efektivit aktiv në territorin e garnizonit si shërbimi i rojeve, stërvitja ditore, veprimtaria kulturore e sportive etj.

Gatishmëria Nr. 2. Efektivi aktiv i njësisë apo repartit, rri pranë vendit të punës apo detyrës, postit luftarak. Trupa rezerviste nuk largohen nga vendbanimi.

Gatishmëria Nr. 1. I gjithë efektivi në postet luftarake, përfshirë rezervistët.



Me Presidentin e CIOR Willem Verheijen

Artileria e gatishmërisë siguronte me zjarr vep-rintarinë luftarake të reparteve që mbronin vijën e kufirit shtetëror apo vijën bregdetare të vendit si dhe ato që mbronin zonat e mundshme të desantimit, në thellësi të territorit të vendit. Në drejtimet tokësore dhe në thellësi të territorit ishin bateritë e lartësisë dhe grupet e artilerisë ndërsa në drejtimin bregdetar ishin bateritë e art. bregdetare dhe artileria tokësore në afërsi të drejtimit detar. Gatishmëria për hapjen e zjarrit prej tyre ishte 15-20 minuta në gatishmërinë Nr.3. Në zonat e desantimit të mundshëm funksiononin edhe SZKZA (sk. zbu. kor. zj. Art.), në FV dhe repartet e gatshme të këmbësorisë. Gatishmëria e kompletimit të plotë me efektivin organik nuk i kalonte 4 orë. Repartet e tjera me rezervistë nuk e kalonin kohën prej 6 orësh të kompletimit. Njësitë arrinin nga 9 deri në 14 orë. Të gjitha repartet e artilerisë, me përjashtim të artilerisë të batalioneve me rezervistë, kishin të përgatitura hartat e kuadratuara të zonës të zjarrit të tyre. Me këto harta ishin përgatitur të dhënat për hapjen e zjarrit për çdo 2 (dy) ha sipërfaqe, në gjithë zonën e zjarrit të baterisë.

Cili ishte prodhimi më i mirë në armatim, armët ruse apo kineze?

Në raport me armët e tjera, artileria arrinte rezultate më të larta, pasi për përgatitjen profesionale të oficerit i kushtohej më shumë kohë dhe kujdes.

Armatimi ishte rus por më shumë kinez. Nga cilësia materiale ishte ai rus, ndërsa si strukturë pajisjeje ishte ai kinez.

Me ndryshimin e sistemit, ishte i domosdoshëm edhe ndryshimi i strukturës, sasisë, cilësisë dhe i strategjisë së ushtrisë, i artilerisë gjithashtu. Ndryshimet duheshin bërë duke mënjeluar teprimet dhe ato që bien ndesh me strategjinë e strukturave ku sot bëjmë pjesë dhe të ruhej skema e një ushtrie që garanton sigurinë e vendit, ashtu siç e kërkon artikulli Nr.3 i Paktit të Atlantikut të Veriut.

Verdi Take: Skënderbegas, ju na deshët dhe ne ju donim me shpirt!

Verdi Take, ishte një prej edukatorëve të dashur skënderbegas, intelektual i cili ka lënë gjurmë në punën e tij si krijues e regjisor, si në këtë shkollë, ashtu dhe në shumë skena teatroshe të vendit. Një meritë e veçantë e tij është puna e palodhur në gjetjen e elementeve dhe zhvillimin e aktiviteteve të shumta kulturore e artistike në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake "Skënderbej" dhe Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha" në Tiranë...

Verdi Take u lind në qytetin e Korçës, më 3 gusht 1938. Në vitin 1961 ka mbaruar shkollën ushtarake në Tiranë dhe është diplomuar oficer. Në vitet 1963-1965, ka qenë komandant toge në shkollën "Skënderbej", ku ka meritën e ngritjes së grupit artistik të estradës, i cili fitoi vendin e parë në Festivalin e Estradave amatore të Ushtrisë (viti 1965). Në atë shfaqje, toger Verdi Take ishte autor i libretit, regjisor dhe konferencier... Me krijimtari letrare, Verdi Take është marrë që në rininë e tij. Ka botuar qindra artikuj publicistik, kryesisht në shtypin ushtarak, ka shkruar pjesë humoristike që janë vënë në skenë nga trupa amatore e profesioniste. Autorësinë e tij e gjen edhe në dhjetëra filma dokumentarë, herë si skenarist, herë si regjisor, autor teksti etj. Ka qenë shef i Sektorit Kinematografik të Ushtrisë pranë Kinostudios "Shqipëria e Re", shef i Estradës Profesioniste të Ushtrisë, shef i Qendrës së Foto-Filmit të ushtrisë dhe regjisor në disa pallate kulture. Ka botuar tri libra me tematikë nga jeta në ushtri. Në konkurset letrare kombëtare, ka fituar dy herë çmime. Një nga filmat e tij dokumentarë, si "Do të kthehemi përsëri", me tematikë nga ngjarjet tragjike të ushtrisë në vitin 1977, u paraqit



në Festivalin Ndërkombëtar të Filmit Usharak, në Rumani, i cili u nderua me "Çmimi i Veçantë". Në vitin 1997, Verdi Take doli në pension. Gjatë viteve të pensionit është aktivizuar me ndihmesën artistike në shkollë të mesme të qytetit të Tiranës. Për këtë është vlerësuar me çmime kombëtare "Mirënjohje". Një kontribut të vyer ka dhënë me pjesëmarrjen në disa televizione, ku është ftuar për të folur për problemet e humorit, për promovimin e filmave të tij dokumentarë dhe tema të tjera shoqërore. Në nëntor të vitit 2017, si skenarist e si regjisor, realizoi filmin dokumentar mbi veprimtarinë e gjeneral major Qazim kapisyzit, film i cili, me kujdesin e Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë, u shfaq në Muzeun Historik Kombëtar

Profesor Verdi në librin historik "Skënderbegasit ndër vite" do të shkruante:

Më kujtohen në ato vite... Na kishin si prindër, sepse edhe ne, komandantët e tyre, silleshim si prindër me ta. Po tregoj, më poshtë, vetëm

një ngjarje, nga dhjetëra që kam në kujtimet e mia.

Nga Shkolla e Bashkuar e Oficerëve, më transferuan në shkollën "Skënderbej", sepse komandanti i asaj shkolle, do të më jepte detyrën e shefit të Klubit të Kulturës. Por, fillimisht, sa të lirohej vendi, më caktoi komandant toge. Unë, të them të drejtën, u mërzhita disi, sepse pasioni im ishte puna artistike. Por më e keqja ishte se, në togën ku më caktuan, kishte një problem: Atë e influenconte jo zëvendës komandanti, por njëri nga nxënësit. Ai quhej Frederik Shqera. Çfarë të thoshte ai, bënte e gjithë toga. Ti udhëhiqte për mirë, hajde de, por ai shkonte kundër "rrymës". I fola dhe i tërhoqa vëmendjen disa herë, por ai as që pyeste për mua. "Si t'ia bëj këtij "shqerës" që po më bëhet si "ujk" në toge", mendoja i shqetësuar. Dhe, një natë, kur isha oficer roje, me 'zyrë' te cepi i derës së hyrjes së shkollës, (në ju kujtohet), në orën një të natës, u ngjita në fjetore dhe, duke ecur shumë ngadalë, shkova te krevati i Fredit. Ai flinte poshtë.

Ishte fund vjeshte. Moti ishte ftohur. Binte dhe një shi i hollë. Kishte rënë përmbys sikur bënte not. Ia largova batanijen dhe i thashë me zë të ulët por të prerë:

- Çohu!
- Çfarë?
- Çohu, të thashë, vishu!
- Ça ke mo, toger?
- Sh, sh, sh..! Vishu dhe hajde me mua.

Kështu, tërë inat, duke më hedhur herë pas here nga një vështrim pre-razi, u ngrit.

- Ee! - më tha ai, duke bërë me kokë.

Hem, thashë me vete, "ec, ec" se ta rregulloj unë ty, sonte në këtë natë ..., në orën një të saj.

Arritëm te zyra e oficerit të rojës. Kur futa çelësin për ta hapur, po më dridheshin duart! Nuk e di, ishte inati, apo më shqetësonte diçka tjetër...!

- Fol një cikë shpejt, se du me shku me fjetë..., - më urdhëroi ai duke më parë drejt e në sy. Ai shikim, iu shtua atij merakut që pata kur mundohesha të hapja derën. Frederiku - shokët e tij duhet ta kujtojnë - ishte i fuqishëm, me një trup të bëshëm...

Ai po dridhej nga pak. Nuk e kishte nga e ftohta se sa nga inati. Unë e dija këtë dhe qëndrova vigjilent ... "Hej dreq, -mendova, - kujdes Verdo se po u egërsua ky "shqera-dash", mund të hash ndonjë bri që të fluturosh jashtë dritares". Në rininë time, kam qenë i dobët në shëndet, i gjatë, i hollë me shumë se duhej... Ju kujtohem, besoj.

Me vete kisha një palë dorashka meshini, të zeza, që kishin një tokëz metalike, të verdhë, për t'u mbërthyer te kyçi i dorës. I nxora, me një lëvizje artistike dhe, u ula mbi tavolinë, duke tundur ritmiksht këmbën me çizme, që varej teposhtë.

- Hë skënderbegas Shqera (e theksova si me ironi)! Ai ngriti kokën, më nguli sytë dhe nuk foli.

- Hë mo, fol! Pse sillesh kështu ti?
- Si sillem, o shoku toger?

- Sillesh ...ja...ashtu ...ma bën togën çorap!

- Pse, ç'a i boj togës, unë?

Vetëtimthi e godita me dorashkën që tundja në duar. Ai u mbush me frymë, bëri vetëm 10 centimetra drejt meje, kurse unë zbrita nga tavolina... dhe peshova fort mbi dy këmbët. E qëllova përsëri, me tepër për të fituar

superioritet. Tokëza e dorashkës e zuri në buzën e sipërme, mbi të cilën u shfaq një bulzë gjaku, i kuq. Ai e ndjeu, i fryu që të mos i rridhte në gojë dhe, pastaj e fshiu me buzën e poshtme.

Në një të qindtën e sekondës, u rrotullova prapa tavolinës dhe, po aq vetëtimthi, u kujtova se pas shpine s' kisha dritaren...

Për fat, ai u mjaftua vetëm me atë shikim të paharruar, që e kam para syve edhe tani që po shkruaj këto radhë.

Duke zbutur gradualisht zërin, i fola për fajet që kishte bërë, për turpin që i vinte vetes dhe familjes së tij, për telashet që më hapte. Ai nuk më ndërpreu asnjë herë, nuk u justifikua por, sytë nuk mi ndau. Dallova që sytë e tij sa vinin dhe e humbnin egërsinë... E shoqërova deri në kapanon, duke ecur pranë trupit të tij që po dridhej disi. Kaluam poshtë mimosave për t'iu shmangur sadopak shiut të hollë që binte.

Në kapanon, hyra para tij. U afruam te krevati pa bërë zhurmë. Hapa batanijen dhe i bëra shenjë të shtrihej. Ashtu bëri. Për habinë time dhe lumturinë e atij çasti, a i u shtri, jo duke më kthyer shpinën por, përballë meje. U përkula, ia mbuloja supet dhe sytë e mi mbetën të ngulur te pikëza e gjakut mbi buzën e tij. Ajo ishte tharë ...!

Të nesërmen në mëngjes, sapo buçiti boria e zgjimit, shkova te vendi ku rreshtohej kompania. Dola para togës dhe, me një qëndrim gatitu, fola me zë të plotë një urdhër që e kisha formuluar orë të tëra gjatë asaj nate të paharruar:

- Toga, gati-tu! Shokë skënderbegas! Duke filluar nga mëngjesi i kësaj dite, zëvendëskomandant i togës, domethënë, zëvendësi im, do të jetë skënderbegas Shqera!

Një mërmërimë miratimi si valë të një kënge korale u përhap në mjegullën e atij mëngjesi. Shi kishte pushuar:

- Skënderbegas Shqera!
- Urdhëroni shoku toger!
- Merrni komandën e togës!
- Si urdhëron!

Ai në krye, toga pas tij, nisën vrapin drejt fushës së sportit, duke kënduar një këngë që ua kisha

mësuar kohët e fundit. Unë nuk komandoja më togën. Porositë ia jepja zëvendësit tim dhe ato zbatoheshin nga e gjithë toga pa asnjë thyerje disipline.

Komandonte Frederik Shqera.

Një vit më pas u transferova përsëri në Shkollën e Bashkuar. Për Fredin, mora vesh se ishte larguar, pa e mbaruar shkollën.

Kishin kaluar shumë e shumë vite. Unë isha regjisor në Pallatin e Kulturës në Shkodër. Një ditë, dezurni me njofton se dikush më kërkonte te dera e hyrjes.

- Po, ngjite lart, - i thashë.

- Nuk desh, po mu lut të dalësh ti poshtë.

Zbrita, i shkujdesur, e nuk hamendësoja fare se kush mund të ishte. Te kolonat e hyrjes të Pallatit të Kulturës, dallova një burrë rreth të dyzetave. I panjohur për mua.

- O komandant Verdi, po nuk paske ndryshuar fare, o toger Take!

U nisëm të dy drejt njeri-tjetrit. E njoha. Ishte Frederiku. Një shije të hidhur ndjeva në gojë, ashtu ndjeva edhe një farë shqetësimi, (nuk e fsheh).

"Ka ardhur të marrë hak", - më fërshëllyen në veshë. Ai zgjati duart, më përqafoi dhe pa me lëshuar foli: "O komandanti im! Kam ardhur në Shkodër për t'u furnizuar me disa materiale nga Uzina e Telave. Punoj në sektorin e riparimit të televizorëve. Aty jashtë pashë disa reklama të shfaqjes dhe në të gjitha ishte emri "Regjisor Verdi Take". Pyeta ku je, dhe ja ku erdha. Nuk mund të shkoja në Elbasan pa të takuar:

Pasi pime nga një kafe, më vuri dorën në sup dhe foli: "Jam bërë djalë i mirë, komandant. Të faleminderit për gjithçka bërë për mua dhe, të kërkoj falje për shqetësimet që të pata hapur dikur!" Ai i hipi motoçikletës, me çantën e mbushur plot me materiale dhe u nis. Unë, gjithashtu i mbushur me emocione, me mall, e më shumë kujtime nga ato vite, qëndrova "gati-tu" duke e përshëndetur me dorë derisa Fredi kaloi përmbi Hotel Turizmit dhe mori kthesën ...!

Eh! Skënderbegas... Skënderbegas! E si mund t'iu harrojmë? Jo, kurrësi! Ju na deshët dhe ne ju donim me shpirt. Qofshi të paharruar!

“Duam të bëhemi ‘Zotër’ dhe kjo na pengon të bëhemi njerëz”



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Sot, më shumë se kurrë është e nevojshme që njeriu të njohë veten, sepse duket qartë, që ai është i prirur më shumë e më mirë të njohë planetët, trupat qiellorë, teknologjinë, gjërat që janë jashtë tij, gjithçkanë e një bote shumë komplekse, sesa njohjen e unit të vet. E duke mbetur kështu, skllav në rrjetën e merimangës së botës dinamike, që rrotullohet vetëm brenda saj dhe që nuk e lejon njeriun t'i kushtojë rëndësi njohjes së vetes, edhe pse kjo e fundit është shumë e nevojshme dhe e rëndësishme.

Njoha e vetes është një art më vete dhe, siç e dimë, për të krijuar një art të mirë kërkohet kohë, vullnet, angazhim e gjithashtu edhe mjete ose ngjyra.

Kjo nuk mund të arrihet për një kohë të shkurtër, e po ashtu, nuk mund të bëhet vetëm pa përfshirë tjetrin. Gjithashtu për të njohur më mirë dhe për të kuptuar se kush jemi, kërkohet edhe një element tjetër që t'i tregojmë vetes historinë tonë. Sepse, ajo nuk arrihet duke lexuar libra psikologjikë, filozofikë, ose portale të ndryshëm, por duke e lejuar veten që të ndihmohemi nga të tjerët.

Njeriu sado që të mundohet ta njohë veten e tij, ajo mbetet e panjohur për të. Njeriu ka për detyrë ta njohë veten e ta kërkojë të vërtetën, ai nuk mund të mbesë human në qoftë se nuk ia arrin kësaj detyre. Pra, kërkohet që ai të jetë në gjendje të dallojë të mirën dhe të keqen, të mësojë të dëgjojë zërin e ndërgjegjes, zërin e brendshëm dhe të jetë i aftë që ta ndjekë këtë zë të brendshëm të zemrës së tij e ta pranojë të vërtetën edhe nëse është e pa këndshme.

Shkaku i madh i sëmundjeve të shumta psikologjike është mosnjohja e vetvetes ose frika e njohjes së vetes, frika e njohjes së emocioneve, impulseve, kujtimeve, aftësive e mundësive. Sepse, njohja e vetes ka të bëjë me marrjen parasysh, jo vetëm të anës më të mirë të vetvetes, por edhe me anën e kufizimeve.

Sipas psikologëve, njeriu ka në vete gjashtë vetë të ndryshëm: njeriu që jemi; njeriu që mendojmë se jemi; njeriu që të tjerët mendojnë se jemi; njeriu që mendojmë se të

tjerët mendojnë se jemi: njeriu që duam të bëhemi dhe njeriu që mendojmë se të tjerët duan të bëhemi.

Të jesh vetvetja, të jesh original dhe të afirmosh çdo ditë unicitetin vetjak

Është thelbësore që të mos biem në kurthin e mas-kave dhe në artin e kamuflimit, i cili në të vërtetë na bën pafundësisht të palumtur.

Por të jesh vetvetja nuk është e thjeshtë. Sidomos sepse jemi mësuar që të vegjël të ndjekim rregulla precize: duke u sjellë në njëfarë rregulli, duke u përgjigjur në një mënyrë të caktuar, duke u shfaqur mirëkuptues edhe kur nuk biem dakord me dikë, duke kamufluar defektet për t'i pëlqyer më shumë dikujt, si dhe një sërë sjelljesh që na kanë mësuar vetëm “sepse kështu duhet”.

Duke u rritur, mendojmë më shumë për shoqërinë, nëpërmjet mediave e marketingut, të cilat na thonë se në ç’ mënyrë duhet të vishemi, çfarë muzike duhet të dëgjojmë, çfarë duhet të hamë dhe të gjitha tendencat e ndryshme që duhet të ndjekim që të jemi në një hap me kohën. Rezultati është: hyjmë të gjithë të bëjmë pjesë në një tufë, të cilën e ndjekim nga pas me kujdes nga frika e mospranimit. Por, në të gjithë këtë “ne”, me mendimet tona, defektet tona, opinionet tona, aftësitë tona, me natyrën tonë të vërtetë... ku jemi?

Reflektojmë mbi gjendjen aktuale, sa prej nesh ndihen si kukulla në duart e dikujt tjetër? Besoj se shumë njerëz gjenden, të vetëdijshëm ose jo, në këtë situatë.

Mendojmë për të gjitha kënaqësitë që marrim kur bëjmë diçka me vullnetin maksimal, apo kur ndihemi të lirë të shprehim mendimin, pa pasur frikën e gjykimit të të tjerëve.

Unë apo ‘uni’?!

Njohja e vetvetes është shtylla e të gjitha virtyteve. Nuk mund të jesh vetvetja nëse nuk di se si je. Ndaj është e nevojshme të dimë se kush jemi, çfarë duam,

Të gjithë kemi një lloj “sinjalizuesi të brendshëm”, i cili në çdo rast e di se çfarë është më mirë për ne. Të shkosh kundër intuitës është njësoj si të mohosh natyrën. Ndaj, bëni gjithmonë atë që ju thotë zemra dhe bëni atë që është më e mira për ju.

Shumë njerëz mundohen me çdo kusht të imitojnë dikë, një të njohur, një mik, një familjar apo, më keq akoma, një personazh publik. Kjo sepse është më e thjeshtë të imitosh të tjerët se sa të punosh mbi zhvillimin e afirmimin e personalitetit personal. Kur mundohemi të imitojmë dikë, jo vetëm humbasim një sasi të madhe kohe, por rezultatet që marrim janë vetëm zhgënjim e frustrim, pasi nuk ia dalim të jemi ashtu siç duam. Nga ana tjetër, afirmimi i vetes, duke kultivuar një stil personal e jetuar sipas shijeve na bën origjinalë e gjenuinë, si dhe më interesante në sytë e të tjerëve.

Gjykimi i të tjerëve ndonjëherë mund të rëndojë shumë.



Sigurisht, njerëzit janë gjithmonë të gatshëm të shprehin mendimin e tyre (edhe nëse shpesh nuk u kërkohet) dhe të japin këshilla sesi duhet të silleni.

Në çfarë mase të tjerët mund ta dinë atë që është më e mira për ju?

Kur zgjedh një rrugë, atë që mendon se është e duhura, mendimet e të tjerëve pak rëndësi kanë, për të mos thënë fare. Për të qenë vetvetja është e rëndësishme të besoni në zgjedhjet tuaja dhe të mos i hyni një rrugë vetëm për të mos zhgënjyer njerëzit që janë pranë jush. Jini të sigurt për veten, për aftësitë tuaja dhe talentin që keni. Braktisni të gjitha pasiguritë që ju transmetojnë të tjerët. Vetëm kjo ju lejon të jetoni mirë, pa pasur peshën shtypëse se çfarë të tjerët mendojnë për ju.

Në një shoqëri ku pjesa më e madhe e njerëzve kanë tendencën të uniformohen me masën, origjinaliteti është virtyti tashmë pothuajse i rrallë. Shumë shpesh të jemi origjinalë është një çështje kuraje, sepse do të thotë të dallohemi e të diferencohemi nga të tjerët, të jemi të ekspozuar më shumë ndaj gjykimëve të tyre.

Të jeni origjinalë, veç të tjerash, do të thotë edhe të ekspozoheni dhe të rrezikoni, sepse të jesh "delja e zezë" jo gjithmonë shihet me sy të mirë dhe është për këtë arsye që rrezikoni të përfshihen për shkak të "diversitetit".

Po a është realisht e rrezikshme kjo gjë?

Më e rrezikshme, në fakt, është të ndrydhni kreativitetin tuaj, vetëm nga frika se mos nuk ju kuptojnë dhe ju paragjykojnë. Nëse hidhni shikimin rreth e qark, mund të vini re që njerëzit që kanë pasur kurajën të diferencohen, janë ata që në rrjedhën e kohës kanë marrë edhe më shumë kënaqësi nga jeta, sepse kanë mundur të shprehin deri në fund atë potencial kreativ, që shumë nuk kanë pasur kurajën ta shfaqin.

Shumë njerëz nuk janë të mësuar të mendojnë vetë dhe të vënë në dyshim ato që shohin, lexojnë apo dëgjojnë. Kështu, shpesh njerëzit pranojnë verbërisht çdo gjë pa pasur një mendim të vetin. Të kesh një mendim personal dhe të keni një qëndrim tuajin, është thelbësore për të qenë vetvetja. Kush mendon me kokën e vet ka aftësinë që t'i shohë gjërat nën këndvështrime të ndryshme dhe

të ndryshojë perspektivën, të kërkojë zgjidhje të tjera, të vlerësojë nëse për çdo gjë ekziston një tjetër mundësi, një alternativë më efikase.

Për të qenë vetvetja, nuk ka nevojë të tradhtosh mendimin tënd, por të shprehësh gjithmonë lirshëm dhe me ndershmëri. Kjo do të thotë, të jeni i singertë në thëniet tuaja dhe të mos fshiheni asnjëherë pas gënjeshtreve për t'u dukur më mirë në sytë e të tjerëve. Shumë shpesh kemi tendencën të gënjejmë edhe për mirësjellje, pasi mbase kemi frikë të ofendojmë dikë.

Të jeni të singertë me të tjerët është thelbësore, por të jeni me veten tuaj, është edhe më e rëndësishme

Duhet të jeni gjithmonë objektivë dhe realistë në atë që bëni dhe mendoni. Duke u fshehur pas iluzioneve e justifikimeve, nuk do të mund të jeni asnjëherë vetvetja. Të vendosni të jeni vetvetja, ashtu si në të gjitha ndryshimet e tjera të jetës, kërkon të bëni zgjedhje të vetëdijshme, por edhe të keni kurajë të madhe. Në këndvështrimin personal, shpërblimi do të jetë shumë i kënaqshëm.

Të gjitha shkencat, vetëm sa i falin njeriut njohuri në lidhje me natyrën dhe e bëjnë atë më të fuqishëm përballë saj.

Misioni më i shenjtë, më urgjent dhe më primar i shkencës duhet të jetë njohja e njeriut. Sepse përpara se t'i bëjmë një shtëpi dikujt, duhet ta dimë se çfarë njeriu është ai. Duhet të dimë përse dëshiron të jetojë atje, ç' person është, ç' dëshira ka etj. S'ka kuptim t'i bësh shtëpi një njeriu pa i ditur këto.

Për fat të keq, vetë humanët u përpoqëm të krijojmë një civilizim, një jetë luksoze, përpara se ta njihim më parë vetë qenësinë e tyre. Një civilizim i tillë, edhe përkundër madhështisë dhe luksit që ka, mund të shkaktojë degjenerim tek njeriu, për shkak të mosnjohjes së njeriut, mosnjohjes së qëllimit të tij dhe të kuptimit të të jetuarit.

Unë me një ton optimist them se "mund të degjenerohet" njeriu. Mirëpo një mendimtar realist, i cili jeton në këtë "shtëpi", nuk do të thoshte se "mund të degjenerohet" por se "është degjeneruar" tashmë.

Miti i 'narcisit' tanimë ka fytyrë, trajtë, gjini.

Jam uni im, i pakontestueshëm, i yti, i juaji po ashtu. Kjo është e vërteta jonë boshe!

Novatorizmi dhe vendosja e teknologjive të reja, objekt i zhvillimit të kërkimit shkencor ushtarak në FA



N/KOL (R) MSC. KANAN HIMAJ

Në kontekstin e kërcënimit terrorist ose faktorëve të origjinës politike, ekonomike, shkencore, etnike, gjeografike, ushtarake, gjeopolitike dhe të tjera, fuqitë e mëdha të botës rezervojnë të drejtën të ndërhyjnë ushtarakisht në çdo vend të botës, duke siguruar, ndër të tjera, gjërat dhe aksesin në burimet strategjike të energjisë, nxitës të rritjes së kapacitetit për të imponuar bërthama të reja globale të energjisë. Në këtë drejtim, koncepti i fundit strategjik i NATO-s thotë se "kërcënimi konvencional nuk mund të injorohet. Shumë rajone dhe vende anëmbanë botës kanë nisur për-vetësimin e aftësive të rëndësishme moderne ushtarake, me pasoja të paparashikueshme për stabilitetin ndërkombëtar dhe sigurinë euroatlantike" (Koncepti Strategjik i NATO-2022). Edhe nëse evolucioni natyror i shoqërisë nënkupton zhvillimin në nivel ekonomik, informatik, social, si në nivel shtetëror, rajonal dhe global, do të ishte gabim të neglizhohej realiteti historik i përjashtimit total të mundësisë së daljes të elementëve ndërshtetërore, që do të jetë përballje, si në të ardhmen e afërt ashtu edhe në atë të largët.

Paparashikueshmëria e mjedisit operacional, e karakterizuar nga një sërë faktorësh politikë, ekonomikë, gjeopolitikë, e drejton vëmendjen tonë drejt teknologjive të reja që do të bëjnë një ndryshim me kalimin e kohës. Mbatja në një hap me vendet anëtare të NATO-s është e mundur duke planifikuar dhe kryer kërkime shkencore në përputhje

me nevojat e zhvillimit konceptual dhe teknologjik të strukturave të FA-së.

Vendimet politike, të shoqëruara me masa të mëdha organizative dhe të mbështetura nga fondet e nevojshme financiare, kanë filluar të materializohen në fushën e kërkimit shkencor në FA, duke ngritur institucione të reja kërkimore shkencore siç është IKSHU, të cilat kanë si objektiv kryesor kërkimin, projektimin dhe pjesëmarrjen në realizimin e pajisjeve ushtarake. Për momentin, ajo ka nisur projekte dhe koordinon me qendrat e kërkimit dhe inovacionit, të pajisura me pajisje moderne që sigurojnë kushtet më të mira për inovacion, modernizim, jashtëzakonisht të dobishme në fushën e informacionit dhe teknologjitë e komunikimit e mbrojtjes dhe teknologjitë ushtarake, sistemet e armëve, forcat ajrore dhe detare.

Për të modernizuar në teknikën e luftimit nëpërmjet inovacionit, është i nevojshëm bashkëpunimi ndërmjet institucioneve kërkimore-shkencore dhe strukturave të posaçme të shtetit, njësisë ekonomike të profilit dhe institucioneve të arsimit të lartë teknik. Analiza e zgjidhjeve të marra në laboratorët e qendrave kërkimore, kontaktimi në praktikë të shpikjeve ushtarake janë hapa të rëndësishëm që po kryhen aktualisht për zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse të vendit.

Studiuesit ushtarakë janë pjesë e procesit të asimilimit të llojeve të reja të pajisjeve dhe materialeve ushtarake. Shumëllojshmëria e fushave të kërkimit, numri i projekteve që mund të financohen dhe të zhvillohen në faza, bazuar në legjislacionin ekzistues, si dhe numri i pajisjeve specifike të përfshira në vendosjen në një nivel të mirë në hierarkinë e vendeve tjera që investojnë dhe marrin produkte.

Udhëheqja e veprimtarisë kërkimore siç është IKSHU mbetet me interes për Sistemin e Mbrojtjes, prandaj ajo ka parashikuar organizimin e shumë aktiviteteve shkencore për vlerësimin shkencor në vend. Veprimtaria e kërkimit ushtarak duhet të çojë në kapitalizimin superior të burimeve në dispozicion, në zhvillimin teknologjik të bazuar në fushat e reja të shkencës

dhe teknologjisë. Në veçanti, kërkimi shkencor duhet të studiojë tërësisht strukturën e materialeve, proceset dhe të zhvillojë produkte me veti superiore, teknologji të reja që plotësojnë kërkesat moderne në fushën e mbrojtjes së vendit.

FA-të kanë filluar të krijojnë bazat fillestare për të arritur rezultatet e punës në fushën e kërkimit shkencor të të gjithë fushës së pajisjeve. Ndoshta e ardhmja i përket qendrave të tilla me ekupe studiuesish kryesorë shkencorë, kimistë, fizikanët, elektronikë, farmacistë, mjekë, biologë, biokimistë, mekanikë, armatime, automobilistë, ushtarakë dhe civilë me asistentë, teknikë, laboratorë, personel të specializuar, të mbështetur logjistikash nga stafi i sektorit administrativ, bënë pajisje specifike me një shkallë të lartë origjinaliteti, situatë që ndikoi pozitivisht në prestigjin e rumunëve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

Duke pasur parasysh nevojën e paraqitjes së shkurtër të ideve, është interesante t'i qasemi fushës së kërkimit të informacionit ushtarak. Prandaj, të gjitha këto do të vlerësohen si etiketa e institucioneve ushtarake të kërkimit shkencor. Gjithashtu, pjesëmarrja në programet kombëtare të kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit dhe duke vlerësuar disa projekte mjaft interesante, duke pasur si përfituese ushtrinë dhe organizata të tjera me atribute në fushën e sigurisë kombëtare, do të dëshmojnë rëndësinë e shkencës në mjedisin ushtarak dhe jo vetëm.

Gjendja aktuale e njohurive për teknologjitë po rritet vazhdimisht për shkak të pjesëmarrjes me personel elitare nga sistemi ushtarak në grupet e punës të organizuara në nivel të aleancave ku jemi pjesë, si dhe në nivel kombëtar nëpërmjet inxhinierëve ushtarakë të ditur dhe të etur për të krijuar gjëra të reja në nivel kombëtar. Vëzhgimi në këtë drejtim do të përcaktojë në mënyrë implicite gjetjen e zgjidhjeve për të thjeshtuar në procesin e planifikimit, zvogëlimin e kohës së caktuar për çdo fazë dhe marrjen e një vendimi optimal për të kryer një operacion ushtarak.



Nga ky këndvështrim, revolucioni aktual teknologjik, i cili përfshin inteligjencën artificiale, digjitalizimin, nuk mund të zëvendësojë arsyen njerëzore, ndjenjat dhe përvojën e personelit ushtarak, ndaj është e nevojshme që zhvillimi i teknologjisë dhe përdorimi i saj në konfliktet e armatosura të bëhet me shumë kujdes.

Në të ardhmen, pritjet që parësisht kostove, futja e algoritmeve të inteligjencës artificiale të çojë në ndryshimin e përmasave të strukturave ushtarake, trajnimin e personelit në kushte reale konflikti nëpërmjet teknologjive dhe pajisjeve inteligjente për të minimizuar humbjet njerëzore. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet burimeve njerëzore, të cilat duhet të përzgjidhen, përgatiten dhe trajnohen në kushte që më vonë do të lejojnë përdorimin e teknologjisë së lartë. Futja e kategorive teknike në fondin ushtarak përcakton stafin e instruktorëve dhe profesorëve ushtarakë për të gjetur metoda kërkimi dhe mësimi të gjeneratës së re.

Në këtë drejtim është detyrimi i drejtimit të të gjitha niveleve për të studiuar nevojën dhe rëndësinë që ka pasur dhe ka inteligjenca artificiale në teknologjinë moderne të përdorur në planifikimin e operacioneve të paqes dhe luftës, në procesin e vendimmarrjes si dhe në teknologjinë e përdorur drejtpërdrejt në kryerjen e operacioneve ushtarake.

Drejtim tjetër që duhet ndjekur është të ndikohet në fuqinë vendimmarrëse, mbi nevojën për të ruajtur ekuilibrin e forcave dhe mjeteve, duke u dhënë shkencëtarëve dhe kërkuesve besim në zhvillimin e teknologjive, për të sjellë strukturat në standardet dhe kërkesat e NATO-s.

Veç sa më lart, drejtimi i analizës do të ishte rritja e karakterit shkencor të kërkimit, duke regjistruar një numër më të madh studentësh në Akademinë e FA-së, duke rritur cilësinë e materialeve dhe pajisjeve të nevojshme për krijimin e shpikjeve, duke vendosur objektiva të qarta për përfituesit e produkteve që rezultojnë dhe duke planifikuar veprimtarinë kërkimore sipas burimeve të mundshme. Ka mundësi që ritmi i zhvillimit teknik dhe shkencor të bëhet më i ngadalshëm për shkak të vëllimit të madh të informacionit që ka pushtuar botën, por eliminimi i faktorëve kufizues si: reduktimi i burimeve njerëzore dhe materiale, pamundësia për të pasur të gjithë rrjedhën e informacioni tekniko-shkencor, rritja e periudhave të shkollimit për shkak të vëllimit të nevojshëm të njohurive, mund të çojë në progres.

Revolucionet teknologjiko - industriale demonstrojnë se teknologjia ndryshon mentalitetin, krijon mundësinë që burimet njerëzore të rrethohen me njerëz me cilësi të lartë dhe u jep kohë për zhvillim intelektual jashtë shërbimit që u siguron atyre jetesën. Padyshim që ndikimi i tyre në FA do të ndihet në prodhimin e produkteve të nevojave ushtarake, gjë që sjell ndryshime të rëndësishme në drejtim, organizim, metodë dhe procedura.

Në kushtet e ristrukturimit të departamentit përkatës në IKSHU arrihet në një përfundim se secili prej nesh është i vetëdijshëm se teknologjia moderne përfshin kosto, por hap pas hapi, me kalimin e kohës, mund të krijojë përfitime për të gjithë shoqërinë në të cilën jetojmë.

Duke promovuar ide moderne dhe aftësi për të ndikuar në drejtimin e buxhetit të kërkimit drejt kërkimit tekniko-

shkencor për zhvillimin e pajisjeve dhe teknikave ushtarake, duke përdorur elitat njerëzore ushtarake dhe civile, si dhe burimet materiale që ekzistojnë në institucione, ne mund të zbulojmë çelësin e suksesit të revolucionit modern të sigurisë dhe mbrojtjes.

Njëkohësisht me zhvillimin e mjeteve të luftimit ndryshon edhe korrelacioni midis llojeve të armëve dhe kategorive të forcave të armatosura. Ndërsa trupat e blinduar u zhvilluan shumë pas Luftës së Dytë Botërore, numri i këmbësorisë u zvogëlua, madhësia e artilerisë u ndryshua, u shfaqën njësi të reja, vëzhgimi i fushëbetejës, mbështetja xheniere luftarake, forcat speciale, duke siguruar mirëmbajtjen e teknologjisë moderne. Kështu, ushtria shqiptare, nën impulsin e përparimit tekniko-shkencor, para së gjithash të informatikës, kibernetikës, elektronikës, është shndërruar në një strukturë më moderne me një numër më të vogël, por të aftë për të përballuar teknikën aktuale, me shumë efikasitet për sa i përket efekteve në luftimet bashkëkohore. Strukturat ushtarake zhvillohen me kalimin e kohës sipas kontekstit social-historik, duke regjistruar mangësi, rivlerësime dhe përmirësime të njëpasnjëshme.

Duke analizuar zhvillimin e strukturave ushtarake në forcat tona të armatosura, si rezultat i procesit të zhvillimit të shoqërisë, është i nevojshëm një rikonfigurim i vazhdueshëm i tyre për shkak të blerjeve të pajisjeve me performancë të lartë. Procesi i transformimit nuk është i lehtë dhe përfshin sakrifica si nga burimet njerëzore ashtu edhe nga burime të konsiderueshme materiale dhe financiare.

“MERCENARËT”

E shkuara, apo e ardhmja e luftës?



KOLONEL HYSNI GJERGJI

Lufta në Ukrainë po sjell në diskutim edhe një fenomen jo të ri të luftës. Qysh në fillim të agresionit, janë shfaqur dhe kanë treguar gatishmëri mijëra të huaj vullnetarë, të luftojnë për Ukrainën kundër Rusisë, si dhe për Rusinë kundër Ukrainës. Shumë analistë e quajnë luftën me mercenarë si luftë të blerë, luftë të shitur, luftë si biznes, luftë me ushtarë të fatit, luftë me paramilitarë, ushtri private, legjionarë, luftëtarë të lirisë, ose thjesht “mercenarë”. Të tjerë i quajnë ushtarë të askujt apo të gjithkujt. Madje disa prej tyre janë nga Rusia që luftojnë kundër Rusisë, duke rikrijuar një panoramë të çuditshme por jo të re të luftës. Armiq që qëndrojnë në të njëjtën anë të barrikadës, patriotë ose tradhtarë në njëjtën kohë, rusë dhe ukrainas që luftojnë kundër rusëve?! Duke qenë se BE-ja aktualisht nuk mund të caktojë zyrtarisht shtetet si sponsorizues të terrorizmit, Parlamenti i bën thirrje BE-së dhe shteteve të saj anëtare që të vendosin kuadrin e duhur ligjor dhe të konsiderojnë shtimin e Rusisë në një listë të tillë. Kjo do të shkaktonte një sërë masash të rëndësishme kufizuese kundër Moskës dhe do të kishte implikime të thella kufizuese për marrëdhëniet e BE-së me Rusinë. Ndërkohë, eurodeputetët, më 23 nëntor 2022, i bëjnë thirrje Këshillit që të përfshijë organizatën paraushtarake ruse ‘Grupi Wagner’, Regjimentin e 141-të Special të Motorizuar, i njohur gjithashtu si “Kadirovitet” dhe grupe të tjera të armatosura, milici dhe përfaqësues

të financuar nga Rusia, në BE si lista terroriste.

Fenomeni i luftëtarit me pagesë, ushtarit profesionist, vrasës me pagesë apo mercenar, siç njihet në histori, nuk është i ri. Ky lloj luftëtar ka shoqëruar luftëtarët që nga lashtësia dhe sot ka marrë emra të tjerë më “patriotikë”. Të tillë janë “legjioni i të huajve”, “kompani sigurie”, “ushtri private” etj. Më i njohuri aktualisht është legjioni francez i themeluar nga mbreti francez Louis-Philippe, më 10 mars 1831. Pas Luftës së Dytë Botërore në Legjionin francez të të huajve, rreth 40 % ishin gjermanë. Në këtë legjion marrin pjesë vetëm të huaj, kryejnë operacione vetëm jashtë Francës, ndërsa oficerët janë vetëm francezë. Pra është legjion i huaj por drejtohet vetëm nga francezë, pasi të huajt përparojnë në gradë deri në nënoficer. Fillimisht në legjionin francez pranoheshin edhe kriminelë, vrasës dhe përdhunues ndërsa aktualisht pranohen vetëm persona me kartelë penale të pastër, ose me krime të lehta.

Heronj apo tradhtarë, kjo varet nga pala që i vlerëson. Rusët e vlerësojnë rusin në llogoren ukrainase si tradhtar, ndërsa ukrainasit e dekorojnë të njëjtin rus si “hero”. Ka pasur disa lloje reagimesh për fenomenin “mercenar” në luftën e Ukrainës me Rusinë, i cili nuk është aspak i ri; Një reagim është ai i qeverive perëndimore që u japin miratimin e heshtur apo të hapur shtetasve të tyre për të ndihmuar Ukrainën të vetëmbrohet; Ndërsa qeveritë aziatike urdhërojnë shtetasit e tyre të mos bëhen pjesë e luftimeve; Ndërsa qëndrimi i autoriteteve ruse dhe bjelloruse, i kanë denoncuar shtetasit e tyre që luftojnë përkrah Ukrainës, por nga ana tjetër kanë krijuar batalione me mercenarë pro rusë.

Ndër luftëtarët pro-Ukrainës të përfshirë në luftime, ka edhe shtetas rusë dhe bjellorusë që kanë ndihmuar prej vitesh për mbrojtjen e Ukrainës. Ka gjithashtu luftëtarë të mërguar çeçenë, të cilët e kanë kundërshtuar Moskën që nga momenti kur Rusia shkatërroi fushatën e tyre separatiste në Çeçeni, pas dy luftërave të viteve 1990 dhe 2000. Luftëtarët çeçenë të cilët janë në Ukrainë që nga viti 2014, duke u rezistuar



forcave ruse dhe separatistëve pro-rusë në rajonin ukrainas Donbas. Përballë këtyre çeqenëve që luftojnë për Ukrainën, është lideri çeqen Ramzan Kodirev që lufton për Rusinë. Sipas gazetës së pavarur bjelloruse "Nasha Niva", në fillim të muajit prill 2022, luftëtarët bjelloruse u shfaqën me emrin e nacionalistit bjellorus të shekullit të 19-të "Kastus Kalinouski". Udhëheqësja opozitare bjelloruse e mërguar në Lituani, Sviatlana Tsikhanouskaya, shpërndau më 13 mars një video në Twitter, të batalionit "Kastus Kalinouski".

Çfarë i shtyn mercenarët të rrezikojnë jetën e tyre, për hir të interesave të njerëzve të tjerë? A është vetëm etja për fitim që tërheq të ashtuquajturat "patat e egra", që shtegtojnë drejt sezonit të luftërave apo burrat rrëmbejnë armët me qëllim që të përjetojnë ndjesi të forta dhe të shuajnë etjen e tyre për adrenalinë? Mercenari, është ushtari që hyn në një konflikt të armatosur jo shumë për arsye patriotike, ideologjike, kombëtare apo politike, por kryesisht për përfitime ekonomike dhe para. Gjithmonë në histori ka pasur, ka dhe do të ketë njerëz, që janë më të aftë se të tjerët të zotërojnë dhe përdorin armë. Një njeri i zakonshëm, i pasur, intelektual, i brishtë dhe i pa trajnuar, ka frikë nga vdekja dhe tërhiqet nga lufta, rreziku, adrenalina, dhe dëshira për të vrarë dhe grabitur.

Ndoshta rolin më të madh në kalimin gradual të ushtrisë nga ushtarë në mercenarë profesionistë e ka luajtur edhe stili luks, dembel, frikakak dhe argëtues i skllavopronarëve të djeshëm dhe oligarkëve të sotëm. Kultura fizike për to është vetëm argëtim dhe në garat e forcës dhe ushtrimet e rrezikshme, skllavopronari "i djeshëm dhe oligarku i sotëm" preferon të jetë spektator, jo pjesëmarrës. Ndonjëherë jeta personale, varfëria dhe rrethanat sociale e detyrojnë një person të marrë armët për para. Ka edhe një kategori tjetër të mençur, pushtetarë të korruptuar dhe të pasur, që i shmangen

luftës. Këta janë "bijtë e ku..vave", të cilët me paratë e fituara janë në gjendje t'i paguajnë çmimin e "gjakut", "bijve të nënave", të cilët luftojnë dhe japin jetën për atdheun, që nuk është vetëm i tyre. Nuk janë parë dhe publikuar asnjë rast ku bijtë e politikanëve ose oligarkëve rusë sot, të rrezikojnë jetën për "Nënë Rusi". Për këtë arsye mobilizohen mercenarët, luftëtarët e askujt apo luftëtarët e të gjithëve.

Fenomeni mercenar, është rritur edhe për arsye të ndërgjegjësimit të patriotëve, të varfërve, të cilët falë epokës digjitale, nuk gënjejn më me propagandë, "patriotizmi" dhe "atdhedashurie". Gjatë muajve të fundit pas shpalljes së mobilizimit nga Putin, turma burrash në moshë për luftë, i largohen një lufte që nuk iu përket atyre dhe

dynden në vendet kufitare me Rusinë. Çfarë janë këta? dezertorë apo tradhtarë? Jo, në fakt këta nuk janë mercenarë të ushtrisë private të Putinit dhe oligarkëve që kanë dhe duan të vazhdojnë të ngrenë perandorinë e tyre, me gjakun e të mashtruarve dhe fatkeqëve. Falë informimit digjital pa kufij, sot nuk ka më "idiotë të dobishëm" në Rusi, apo dhe në botë, që japin jetën për të mbrojtur pasuritë e të korruptuarave. Fëmijët e të pasurve janë të "bunkerizuar" dhe presin sa të mbarojë lufta, për të punësuar patriotët e "gjakosur" që kanë mundur të mbijetojnë, në bizneset e tyre për të bërë para me "djersën" e tyre.

Fuqia luftarake e mercenarit është trajtuar edhe nga Holliwood me të njëjtin emër, ku aktorët më të njohur të filmave aksion, që vijnë nga shtete, besime, raca, punësohen për të "kryer një punë". Në historinë e luftërave, rasti i parë i njohur i përdorimit të mercenarëve është regjistruar rreth 3500 vjet më parë. Në ushtrinë e Egjiptit, ku ata zinin rreth 50% të gjithë luftëtarëve; Në Betejën e Gaugamelës, 9000 grekë luftuan për Aleksandrin e Madh. Në shekullin III-të para Krishtit u vendos edhe baza ligjore e kohës e njohur si "Marrëveshja me ushtarët mercenarë" të mbretit të Pergamonit Eumeni I. Kjo marrëveshje i përcaktoi qartë kushtet e punës: pagë, pushim 2-mujor pas 10 muajsh shërbimi si dhe pension për jetimët në rast vdekjeje të babait luftëtar (mercenar).

Mercenarët ishin një instrument lufte, dorë e fortë dhe gjakatare i shtypjeve të rebelimeve dhe grindjeve të shtresave të ndryshme civile. Mercenarët nuk kanë atdhe, moral dhe ideologji, ata i shiten gjithkujt që paguan më shumë. Luftëtarët sllavë për shembull vlerësoheshin veçanërisht si truproje të afta për sultanët e Turqisë, Sirisë dhe Egjiptit. Këta badigardë formonin një kastë të privilegjuar ushtarake bashkë me jeniçerët dhe mam-lukët, që mbronin jetën e sultanëve me jetën e tyre.



Një nga arsyet e fitoreve të mercenarëve ishte tmerri që ata përhapnin te kundërshtarët me mizorinë e tyre. Mercenarët zviceranë për shembull, e kishin të ndaluar të kapnin robër; të gjithë ata që ranë në duart e tyre u vranë. Disfata e mercenarëve erdhi nga dekompozimi i fuqisë së tyre ushtarake, nga paratë. Lakmia për para iu dha mercenarëve guxim të pamatur, gati një çmim për çdo sulm, pavarësisht se ku dhe kur bëhej.

Rekrutimi ishte i vlefshëm vetëm për kohëzgjatjen e luftës, lejoheshin të vishnin edhe rroba dhe të silleshin sipas dëshirës së tyre, ndryshe nga ushtria e rregullt. Perandori Maksimilian shkruan: "Jeta e mercenarëve është e shkurtër, e shurdhër, pa shpresë për jetëgjatësinë, ndaj dhe rrobat e tyre shumëngjyrëshe janë një nga gëzimet e pakta. Le ti veshin ato". Maksimiliani ishte katolik, dhe luftonte kundër princave protestantë të Gjermanisë, por në ushtrinë e tij ai kishte rekrutuar edhe mercenarë protestantë. Zyrtarisht ekzistonte edhe "kod nderi", por mercenarët e mbanin mend dhe e respektonin atë, për aq kohë sa ishte fitimprurës: biznesi është biznes. Në librin "Taktika" të shkrimtarit ushtarak Enea shkruhet: "Në një ushtri mercenare, kandidati thirret në heshtje, me marrëveshje dhe pa ceremoni. Nëse një mercenar dëshiron të largohet ai mund ta bëjë atë menjëherë, por në rast se dezerton gjatë betejës, ai shitet në tregun e skllëvërve"

Për shekuj me radhë, mercenarët dhe "punëdhënësit" e tyre, megjithëse duke luftuar në të njëjtën anë të barrikadave, mbetën ende armiq. Truket e punëdhënësve shpesh kanë shkaktuar trazira të vërteta midis luftëtarëve profesionistë. Ndonjëherë mercenarët e merrnin pushtetin dhe këtë e shisnin më vonë, me para. Për shembull, në Sirakuzë dhe Heraklea, mercenarët

pasi kishin kryer një grusht shteti nën udhëheqjen e komandantit të tyre, e bënë atë tiran (sundimtar).

Mercenarët janë luftëtarët e duhur të luftërave të fshehta, pasi pikërisht për këtë arsye politikanët rekrutojnë mercenarët, të cilët janë të përsosur për rolin e ushtarëve të luftërave të fshehta. Ndryshe nga një ushtar i rregullt, mercenarët mund të mohohen dhe "sponsorët" të qëndrojnë me duar të "pastra" dhe të ruajnë reputacionin e tyre. Spiunët dhe sabotatorët zgjidhen dhe rekrutohen, me marrëveshje për t'u mohuar. Asnjë shtet nuk i merr në mbrojtje dhe nuk pranon se është pas këtyre sabotatorëve apo spiunëve. Ata thjesht paguhen për punën e kryer dhe marrëdhënia mbaron këtu.

Gjatë luftës së ftohtë në fillim ishte perëndimi që krijoi shumë "ushtri private" nëpërmes kompanive private ushtarake, që në thelb ishin qendra të ligjshme rekrutimi të mercenarëve të kohëve moderne. Rënia e BRSS në vitin 90' dhe shpërbërja e ushtrisë sovjetike shtruan përpara ushtarakëve profesionistë, pyetjen: "Çfarë duhet bërë me atë që dimë të bëjmë më mirë?" Kishte nga ata që, duke gjykuar se nuk mund të bënin gjë tjetër, vendosën t'i riktheheshin profesionit që u kishin mësuar gjithë jetën. Për fat të "mirë" kishte dhe ka luftëra (punë) për të gjithë.

Sipas informacioneve nga media, punonjës të rinj të KGB-së të BRSS, të cilët mbaruan shkollën e spiunazhit në 1988, dhe në 1991 shkuan në Afrikën e Jugut "për të punuar" dhe u bënë "ushtarët e parë të fatit", kështu quheshin mercenarët atje. Duke filluar nga viti 1990, shtypi rus publikonte informacione në lidhje me pjesëmarrjen në konfliktet e armatosura në territorin e ish-BRSS të mercenarëve nga radhët e ish-oficerëve

sovjetikë. Shpejt fama e mercenarëve rusë u dëgjua edhe në Jugosllavi si dhe në vendet e kontinentit afrikan, duke mbjellë panik në kampet armike. Në këtë kohë oficeri i KGB-së Vladimir Putin, sot president i Rusisë, ishte 38 vjeç.

Aktualisht në Ukrainë po lufton grupi i njohur i mercenarëve "Wagner" ose siç etiketohet nga media, ushtria private e Putin. BBC-ja ka zbuluar rolin kryesor të një ish-oficeri, 51-vjeçari, Dmitri Utkin, themelues i "Wagner" dhe veteran i luftërave çeçene, një ish-oficer i forcave speciale dhe nënkolonel i GRU-së. Grupi "Wagner" fillimisht hyri në veprim gjatë aneksimit të Krimesë nga Rusia, në vitin 2014, me luftëtarë nga Çeçenia, Siria, Libia etj. Mendohet se mercenarët e "Wagner" janë rreth 1000 mercenarë, të cilët po mbështesin milicët pro-rusë që luftonin për kontrollin e rajoneve të Luhanskut, Donetsk, Zaporizhzhia dhe Kherson. Që nga fillimi i luftës në Ukrainë, "Wagner" ka hapur qendra rajonale rekrutimi në 20 qytete ruse, me pagë mujore prej më shumë se 240 000 rubla (ose 3 370 dollarë).

Udhëheqësi i grupit "Wagner", Yevgeny Prigozhin, i cili është bashkëpunëtori ngushtë i Putinit, raportohet nga radio "Europa e Lirë" se ka rekrutuar mijëra të burgosur rusë për luftën në Ukrainë. Bllokimi në fushëbetë, ia kanë vështirësuar Rusisë mbajtjen e fronteve në pjesën jugore dhe lindore të Ukrainës që ende janë të pushtuara, dhe e kanë detyruar Kremlinin që të shpallë mobilizim dhe gjithnjë e më shumë po varet nga mercenarët apo trupat çeçene për të mbushur radhët. Putin tha, më 4 nëntor 2022, se vazhdojnë përpjekjet për rekrutimin e vullnetarëve, pavarësisht shumë treguesve se mobilizimi nuk po vazhdon siç ai dëshiron në Rusi.

Më 5 nëntor 2022, VOA raporton se Komanda ruse e operacionit ka krijuar njësi speciale, të cilat arrestojnë dhe qëllojnë mbi dezertorët, numri i të cilëve sa vjen dhe shtohet. Krijimi dhe përdorimi i një ushtrie mercenare është kundër kushtetutës ruse, megjithatë, "Wagner" i ofron qeverisë ruse një forcë që është ligjërish e mohueshme. "Wagner" është përfshirë në luftime të përgjakshme jashtë Rusisë, por Kremlin mundet të thotë: "Nuk kanë të bëjnë fare me Ushtrinë ruse". "Wagner" është shfaqur më 17 janar 2023 edhe në Beograd, ku po zhvillohen edhe protesta kundër prezencës së tyre nga shoqëria civile serbe. Murale të kafkës së vdekjes, simbol i trupave "Wagner" është vizatuar në mes të Beogradit në kuadër të rekrutimeve për në Ukrainë të rekrutëve serbë.

Rusia madje edhe kundërsulmon nëpërmes ambasadës së saj në Tiranë, më 18 qershor 2022, dhe akuzon shumë vende për mbështetjen e Ukrainës me luftëtarë të huaj. Sipas Rusisë 150 shqiptarë kanë shkuar në Ukrainë, ndërsa llogaritet të kenë humbur jetën 42 persona, 40 janë larguar ndërsa 68 janë ende në Ukrainë, lajm që u hodh poshtë me të drejtë nga ministria Xhaqka. Emanuel Bazanji, është i vetmi ish-ushtar shqiptar i bashkuar para pak muajsh komandës së "Legjionit Kombëtar të Gjeorgjisë". Në Ukrainë ky ish-ushtar shqiptar

nderohet, por nëse kthehet në Shqipëri ai do dënohet sipas ligjit për pjesëmarrje në luftëra në shtete të huaja, parashikuar nga kodi penal i RSH.

Mediat e pavarura dhe opozita ruse, në tetor 2022, raportojnë se po rekrutohen kriminelë nga burgjet ruse në këmbim të lirisë, me kushtin që të qëndrojnë në frontin e luftës të paktën për 6 muaj. "Wagner" rekruton kryesisht veteranët e ushtrisë që duhet të paguajnë borxhe, që vijnë nga zonat rurale me pak mundësi për të fituar para. Në javët para pushtimit rus të Ukrainës, është zbuluar se mercenarët e Grupit "Wagner" kryen sulme me "flamur të rremë" nga Ukraina lindore, për t'i dhënë Rusisë një pretekst për të sulmuar. Grupet mercenare ruse operojnë edhe me emra të tjerë si "The Hawks", sepse emri "Wagner" është shumë i ndotur tashmë. Kush i financon mercenarët "Wagner"? Dyshohet se agjencia e inteligjencës ushtarake ruse GRU, financon dhe mbikëqyr fshehtas Grupin "Wagner". Me mercenarët ndonjëherë ndodhin gjëra komike. Pilotët rusë morën pjesë në konfliktin dhjetëmuor midis Etiopisë dhe Eritresë. Gjatë konfliktit, një Su-27 etiopian rrëzoi një MiG-29 Eritrean, ndërsa të dy pilotët ishin mercenarë rusë.

Gjatë agresionit serb në Kosovë, serbët rekrutuan mercenarë ushtarakë rusë profesionistë kryesisht të ndërlidhjes me radio, si dhe njohës të raketave kundërajrore, që të qëllonin avionët e NATO-s. Sipas Fondit për të Drejtën Humanitare në Beograd, mercenarët rusë dhe paramilitarët serbë të Bosnjës kanë qenë aktivë në rajonin e Rahovecit në Kosovë, gjatë fushatës së bombardimeve të NATO-s më 1999. Gazetari amerikan Roy Gutman, që punonte për gazetën "Newsday" të Nju-Jorkut, raportonte se kishte parë vullnetarë rusë, në vijat e frontit të vrasjeve që u bënë në fshatrat Krushë e Madhe, Piranë, Samodrazhë, Korishë, Bellacërkë, Pustosellë dhe Drenoc. Në prill të 1999 në afërsi të Pashtrikut, UÇK-ja kishte zënë rob dhe ia dorëzoi NATO-s një mercenar rus. Po ashtu, gazeta e përditshme ruse "Novye Izvestia" raportonte për arritjen e një kufome në Moskë, që ishte trupi i pajetë i rusit 34-vjeçar Fjodor Shulga. Në fund të majit 1999, UÇK-ja ia dorëzoi Kryqit të Kuq kufomën e një mercenari rus, 33-vjeçarit Toger Vitali Bukharin (apo Bulakh). Në Gjakovë, një mercenarë rus pjesëtar i brigadës 549 të motorizuar ka vrarë tre burra shqiptarë, sipas dëshmisë së nënës së shqiptarit që ishte me kombësi ruse, e cila e kishte kuptuar shumë mirë gjuhën e mercenarit. Njësia më famëkeqe luftarake e mercenarëve rusë që luftuan për serbët ishte çeta e "ujqërve", e përbërë nga ish-ushtarë të forcave speciale. Këto mercenarë paramilitarë, vrisnin, përdhunonin, vidhnin dhe plaçkitnin familjet shqiptare. Ka rreth 20 mijë denoncime nga gratë e përdhunuara kosovare të vdekura dhe të gjalla, si viktima të paramilitarëve serbë dhe rusë. Është therës fakti i fundit ku, më 3 tetor 2022, një gjykatë në Serbi kërkon dëmshpërblim në mijëra euro të paramilitarëve serbë "ujqërit", pasi janë diskriminuar në pagesa, gjatë luftës së 1999.



Historia e krimit që ndryshoi botën

Në vitin 2005, Asambleja e Përgjithshme e OKB-së miratoi një rezolutë që shpallte 27 janarin, si Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit në nderim të viktimave të Holokaustit. Kjo ditë përkujton miliona viktima të politikave të gjenocidit të Gjermanisë naziste, që u kryen gjatë Luftës së Dytë Botërore, si dhe përqendrohet në përpjekjet bashkëkohore për të luftuar urrejtjen dhe anti-semitizmit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore rreth gjashtë milionë njerëz u vranë, në përpjekjen sistematike naziste për shfarosjen e hebrenjve.

Në kampin Aushvic humbën jetën më shumë se një milion njerëz, të vrarë në dhomën e gazit, të rraskapitur nga kushtet e pamundura të pu-

nës, ekzekutimet e shumta, rrahjet dhe torturat nga agjentët. Viktimat ishin kryesisht hebrenj, rusë, polakë dhe rom. Kampet e vdekjes apo siç kujtohen sot, vendet e terrorit u çliruan më 27 janar 1945, në të cilat u gjetën ende gjallë 7 mijë të burgosur.

Në vitin 1933, Partia Kombëtare Socialiste e Punës mori pushtetin në Gjermani, me diktatorin Adolf Hitler, si lider i saj. Nazistët kishin pasur edhe më herët mbështetje të fortë në Nuremberg dhe për arsye politike dhe më shumë praktike, zgjedhën këtë qytet për të mbajtur edhe fushatat e tyre mes viteve 1933-1938. Në shtator të 1935, ligji i Nurembergut, që shtypte të drejtat civile të hebrenjve kaloi.

Një vit më vonë, në 36-ën, anëtarët e vjetër të Partisë Na-

ziste, përfshirë këtu edhe Hitlerin dhe Rudolf Hess, që më pas u bë komandanti më jetëgjatë i kampit të përqendrimit të Aushvicit, mbërritën në Nuremberg për të parë qytetin e për të organizuar një takim atje si dhe për të zbarkuar trupat ushtarake, që mbajtën edhe një marshim gjatë Kongresit vjetor të Partisë Naziste.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, forcat pushtuese gjermane ngritën kampin Aushvic-Birkenau në jug të qytetit polak të Osviecim, rreth 70 km nga qyteti i dytë më i madh i Polonisë, Krakov. Aushvic u ngrit në maj të 1940 në ish-kazermat e vjetra ushtarake të Polonisë. Viktima e parë në këtë kamp u regjistrua në shtator të 1941-shit, pasi vdiq në një nga dhomat e gazit. Aushvic II apo Birkenau u hap në tetor të vitit

1941. 4 dhoma të mëdha gazi u shtuan kampit për 3 muaj, gjer në janar të vitit 1942.

Mes viteve 1940-1945, Aushvic u shndërrua në një kamp të mirëfilltë vdekjeje, me një kompleks kazer-mash, fabrikash, dhoma gazi e krematoriume, ku humbën jetën thuajse 1,5 milionë njerëz, shumica prej tyre hebrenj. Grupi më i madh i viktimave, gati 75 mijë vetë, ishin polakë. Prej tyre, gati 20 mijë ishin romë.

Në fund të vitit 1941, nazistët formuluan "Zgjidhjen finale". Vendimi për të vrrarë e ekzekutuar 11 milionë hebrenj u mor gjatë Konferencës "Wannsee", që u mbajt pranë Berlinit, në janar të vitit 1942, ku zyrtarët më të lartë nazistë koordinuan lëvizjet, për atë që do të shndërrohej në makinerinë më të ashpër të vrasjeve masive në histori.

Nazistët dizajnuan dhe përmirësuan mekanizmin e ri të vrasjes së njerëzve. Të burgosurit u vranë me gaz, në dhomat e ndërtuara enkas për këtë qëllim e të pajisura me gazvdekjeprurës Zyklon B. Radha për të bërë dush ishte justifikimi më i zakonshëm për t'i marrë të burgosurit nga dhomat ku qëndronin në kamp e për t'i futur më pas në dhomat e gazit. Tonelata me flokë të prera nga kokat e të burgosurve dhe rrobat e çizmet e tyre, u gjetën më vonë, pasi kampi u çlirua.

Aushvic u lirua më 27 janar të vitit 1945 nga ushtria sovjetike, ushtarët e së cilës arritën të shpëtojnë e të nxjerrin të gjallë nga kampi famëkeq 7 mijë të burgosur, pasi gjermanët u tërhoqën. Kampet u shndërruan në simbolikën e holokaustit, me thuajse 1,5 milionë të burgosur që humbën jetën në dhomat e gazit, në temperaturë disa gradë nën zero, nga uria, sëmundje të ndryshme mjekësore dhe nga puna e sforcuar, e rëndë dhe me orë të gjata.

Disa muaj pas çlirimit të kampit të Aushvic, 45 roje të kampit të përqendrimit dolën përpara gjykatës në Lueneburg, qyteti në veri të Gjermanisë, nën akuzën e vrasjeve në masë. Të akuzuarit ishin meshkuj e femra, që për më shumë se 5 vite shërbyen si roje por quheshin funk-

sionarë të të burgosurve. Të 45-të kishin punuar në kampet e Aushvic dhe Bergen-Belsen ndaj dhe gjyqi ndaj tyre u njoh si "Gjyqi Belsen".

Joseph Kramer, i njohur gjersisht si "Bisha e Belsen" ishte komandanti i dy kampeve, që shërbeu fillimisht në Aushvic, ku vuri diktatin e tij dhe më pas në Bergen-Belsen. Ai u arrestua pak pas çlirimit të kampit dhe u dënua me vdekje nga një gjykatë ushtarake britanike, e cila e dënoi me varje.

Irma Grese ishte një roje, krahu i djathtë e paraushtarakëve nazistë në kampet e përqendrimit të Ravensbruck dhe Aushvic. Ajo u dënua gjithashtu me vdekje dhe u ekzekutua në dhjetor të vitit 1945.

Më 20 nëntor të vitit 1945, sytë e të gjithë botës ishin fokusuar në Pallatin e Drejtësisë në Nuremberg. Vetëm 5 muaj pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, 21 ish-drejtes të lartë të partisë naziste dolën në gjyq. Mbi ta rëndonin 4 akuza: plan i përbashkët apo komplot, krime kundër paqes, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Mes tyre spikatën emrat e Hermann Goering, ish-marshall, besnik i Hitlerit dhe shef i "Luftwaffe", një njësie ajrore që bashkërendonte veprimet me ushtrinë gjermane si dhe Rudolf Hess, zëvendësi i Hitlerit dhe komandanti më jetëgjatë që ka shërbyer në kampin e Aushvic.

Bashkë me to, përpara gjyqit doli edhe Joachim von Ribbentrop, ish-ministër i jashtëm. I destinuar për të vijuar për plot 10 muaj, gjyqi u mbajt në qytetin ku partia naziste organizonte takimet e saj të përvitshme. Gjykata e gjeti Goering fajtor për të 4 akuzat dhe e dënoi atë me vdekje. Goering helmoi veten në qeli, pak minuta përpara ekzekutimit. Edhe Von Ribbentrop u shpall fajtor për 4 akuza dhe u var bashkë me 10 të akuzuar të tjerë, më 16 tetor 1945. Rudolf Hess, zëvendësi i Hitlerit po ashtu u gjet fajtor dhe u dënua me burgim të përjetshëm, pavarësisht argumenteve të gjykatës sovjetike se ai duhej dënuar me vdekje, njësoj si të tjerët.

"Privilegji i çeljes së gjyqit të parë në histori për krime kundër paqes në botë, të vendos përpara

një përgjegjësie të jashtëzakonshme. Veprimet e gabuara që ne kërkojmë të dënojmë dhe ndëshkojmë kaq qenë aq të përlogaritura, aq të këqija dhe aq shkatërruese, sa civilizimi s'do të mund të tolerojë që ato të injorohen sepse nuk duhet të përsëriten kurrë më", - shprehej asokohe gjykatësi John Jackson.

Ajo çka mbetet është thjesht përkujtimi, rikthimi në kohë për të mësuar të vërtetat e asaj çka ndodhë, përmes historive njerëzore, edhe të atyre që i mbijetuan kampit. Sot ai është shndërruar në një muze, i frikshëm për nga ndjenja që përcjell, edhe pse më shumë se 2 milionë njerëz e vizitojnë atë çdo vit. Vizita atje nuk është një mësim për historinë por një moment reflektimi mbi përgjegjësinë. I gjithë kampi përbëhej nga një kompleks ndërtesash, ish-godina të vjetra në shërbim të ushtrisë polake, ndarë në vitin 1940 në 40 ndërtesa përqendrimi dhe asgjësimi, siç quheshin nga nazistët. Më i madhi ishte Aushvic, më pas Birkenau, të cilat iu shtuan edhe dhomat e gazit si dhe një kamp më vete pune, për të krijuar aty agjentët kimikë. Të burgosurit në kamp torturoheshin nga rojet, rriheshin dhe më pas ekzekutoheshin për motive të ndryshme.

Më famëkeqi ishte Blloku 11, atje ku në gusht të 41-shit, nisën edhe ekzekutimet në dhomën e gazit. 802 të burgosur tentuan të arratiseshin, 144 ia dolën me sukses. Vetëm 789 vetë, pjesë e stafit që kujdesej për kampin, dolën përpara gjyqit pas çlirimit të tij, gati 15% e totalit. Në dekadat pas luftës, të mbijetuarit e Aushvic si Primo Levi, Viktor Frankl dhe Elie Wiesel shkruan kujtimet për eksperiencën e tyre dhe kampi u bë simbol dominues i Holokaustit. Në vitin 1947, Polonia vendosi krijimin e Muzeut Shtetëror të Aushvic-Birkenau dhe në vitin 1979 ai u bë pjesë e trashëgimisë botërore të UNESCO-s.

Dëshmitë e të mbijetuarve

Tatyana Fomina ishte një vajzë e vogël në atë kohë por dëshmitare e gjithçkaje ndodhi në Aushvic. Bashkë me familjen, Tatyana jetonte në një fshat të Bjellorusisë ndërsa pa babanë e saj, të digjej i gjallë nga

trupat gjermane në vitin 1943. Në tetor të atij viti, Tatyana dhe familja e saj, ajo që i shpëtoi zjarrit, u dërgua në kampin famëkeq. Rrëfimi është i jashtëzakonshëm dhe ajo mban mend çdo detaj, të çdo dite të kaluar në Aushvic.

“Babai im më mbështolli me lëkurë dhe më dorëzoi tek nëna. Ajo ish ulur bashkë me vëllezërit dhe motrat, ishim 4. Më dorëzoi tek nëna dhe tha: Agasha, të lutem, kujdesu për më të voglën. Ajo ishte hera e fundit që unë e pashë tim atë”, - kujton ajo. “Ata na shtynë pas 500 metra, në hyrje të pyllit dhe po rrinim pranë njëri tjetrit dhe shihnim të frikësuar sesi gjermanët derdhën benzinë e vajguri gjithandej dhe më pas i vunë flakën. Ne rrinim e shihnim sesi të dashurit tanë u dogjën të gjallë. Nazistët na merrnin në fëmijëve gjak, na merrnin shumë gjak, sidomos djemve që ishim më të fortë, aq sa ata më pas humbnin ndjenjat. Nëse kalonin në atë gjendje, direkt i dërgonin në krematorium”.

Tatyana tregon fotot e fëmijërisë... “Nuk kishim fare fuqi, nuk na lejonin të flisnim as në rusisht apo bjellorusisht, lejohej që të flisnim vetëm në gjuhë polake apo gjermanisht por ne nuk dinim. Nëse rojet na dëgjonin që flisnim me njëri tjetrin në gjuhën amtare, na ndëshkonin. Në fund të kazermave, kishte një tualet të madh, ku çdokush mund të zhytej brenda, të mbytej me forcë e gjithçka tjetër. Ne kishim frikë nga gjithçka, ne donim të jetonim. Mendonim që së paku nëna jonë të ishte gjallë sepse babanë e dinim tashmë që kishte vdekur. Shpresonim që të shpëtonim”.

Tatyana atëherë ishte vetëm 8 vjeçe, nuk e mban mend ditën e çlirimit por kujton që më pas e dërguan në një jetimore në Moskë, së pari për të marrë veten fizikisht e mendërisht, derisa nisi shkollën në vitin 1946.

Në kërkim të të afërmeve

Një fotografi e vjetër dhe teknologjia më e fundit, ajo e njohjes automatike të fytyrës, mund të ndihmojë sot 2 vëllezër izraelitë të bien në gjurmët e vëllait tjetër, që i shpëtoi holokaustit, 75 vite më

parë. Në kërkim të një përgjigjeje nga e shkuara, Eli dhe Saul Lieberman janë rikthyer në qendrën e kërkimit në Izrael, ku teknologjia sot ofron mundësinë e përshtatjes së fotografive të të mbijetuarve me fotot e vjetra të kohës së Luftës së Dytë Botërore, në databazën me mijëra foto, të realizuara në atë kohë nga vetë ushtarët gjermanë. Në foto shfaqen vetë ushtarët gjermanë si dhe njerëzit në fshatrat apo qytetet me popullsi hebreje. “Kemi shumë pak informacion rreth vëllait tim, dimë shumë shumë pak. Gjithçka di i kam mësuar nga burime të huaja. Ndërsa për babanë, nuk mësuam kurrë asgjë”, - tha Saul Lieberman, i mbijetuar.

Qendra Përkujtimore e Holo-

parë që synon të krijojë një përballje, një për afrim të realitetit sot dhe historisë së 75 viteve më parë, pas holokaustit. Ai nuk ishte vetëm realiteti i 6 milionë hebrenjve, që humbën jetën. Është edhe realiteti e historia e atyre që i mbijetuan atyre torturave dhe atij kampi vdekjeprurës e të cilët prej asaj kohe nuk kanë asnjë lidhje me të shkuarën”, - shprehet Avraham Krieger, drejtor i qendrës përkujtimore “Shem Olam”.

Deri më tani, qendra e kërkimeve Shem Olam, ka marrë mijëra foto nga publiku por vetëm disa prej tyre kanë përkuar me njerëzit që kërkojnë të afërmit. “Po flasim për disa teknologji të avancuara, të cilat ne i përdorim. Gjithçka ofrohet falas për publikun, në mënyrë që çdokush



kaustit “Shem Olam” ka lançuar projektin e quajtur “Ballë për ballë”, ku përmes rrjeteve sociale i bën thirrje njerëzve të dërgojnë foto për njohjen e përshtatjen e fytyrës përmes skanimeve.

Vetë Eli dhe Saul janë të mbijetuar të kampit të Aushvic. Përmes fotove të vjetra të viteve 45-50, ata synojnë të gjejnë të vëllain e të mësojnë për historinë e familjes së tyre.

“Ballë për ballë” është projekti i

të mund të gjejë e të krijojë kontakte me familjarët e tyre, të zhdukur pas holokaustit”, - thotë Assaf Fassy, menaxher i shërbimeve digjitale.

“Mendoj se nuk mund të vazhdojmë përjetësisht me idenë se nuk dimë asgjë. Jetojmë në këtë botë, ku s'mund të sigurojmë më asnjë dokument tonin. Jetojmë në një botë ku vajza ime, të gjithë miqtë e saj, e dinë historinë e tyre. Kjo ka sens. Njerëzit duan të dinë nga vijnë”, -

thotë Saul Lieberman, i mbijetuar.

"Mjaftonte një tatuazh që të mbetet në trup e në lëkurë për gjithnjë. Ai ishte emri nga dita kur shkelle në Aushvic. Një numër që të shoqëron përjetë e që është numri i të burgosurit e që përkon me ditën kur mbërrije në kamp"... Avraham Harshalom mbërriti në Aushvic në vitin 1943. E mban mend shumë mirë numrin e tij.

"Në Aushvic askush nuk dinte emra. Oficerët gjermanë, kur flisnin me ty, të thërrisnin në emër. Është histori e gjatë. Por 20 vitet e para pas holokaustit, të gjithë ne të mbijetuarit, e kryesisht të burgosurit e Aushvic, nuk flisnim fare, as me median e as me njëri-tjetrin. Ne nuk tregojmë sepse njerëzit nuk na



besojnë por sepse kur na dëgjojnë, thonë: si ka mundësi që nga gjithë ai ferr, ju mbijetuat? Dhe historia e mbijetesës është vërtet histori e komplikuar. Çdokush nga ne, ka historinë e tij se si mbijetoi", - thotë ai.

Harshalom është një nga 200 mijë të mbijetuarit e Holokaustit, që sot jeton në Izrael. Ai thotë se çdo vit që kalon, aq më të pamundur e ka të sigurojë, edhe për veten e tij, prova të krimeve të frikshme të

kryera nga nazistët gjatë Luftës së Dytë Botërore, ku 6 milionë hebrenjtë humbën jetën. Harshalom kish lindur në një fshat të vogël të Polonisë dhe ishte 17 vjeç kur mbërriti në kamp. Menjëherë u përzgjodh nga oficerët si krah pune dhe kjo duket se i shpëtoi jetën. Ata që nuk pranonin punën, dërgoheshin menjëherë në dhomat e gazit: dënim me vdekje. Në Aushvic, Avraham humbi nënën dhe vëllain.

"Njerëzit atje ndaluan së menduari normalisht. Truri nuk funksiononte më. Të gjithë ne mendonim vetëm sesi të siguronim veç një copë bukë dhe sesi të mos vriteshim nga gjermanët".

Artemis Meron, nga një komunitet hebre në Greqi, ishte 15 vjeç në vitin 1944, kur u dërgua në Aushvic me nënën dhe vëllain 9 vjeç. Ajo tregon se shumë njerëz humbën jetën që rrugës, pa mbërritur në kamp.

"Ne nuk dinim ku po shkonim. Donim vetëm të ishim bashkë. U përqaftuam. Mendoj se ngjaja më e madhe në moshë për shkak të një palltoje me pelush që nëna më kish hedhur krahëve sepse jashtë binte borë. Gjermanët menduam se jam e rritur dhe më goditën, me hodhën në tokë dhe nënën e vëllain i futën në një makinë, e mbyllën derën dhe u larguan. Nuk pata rastin as t'i them lamtumirë, arrita të thosha nën zë vetëm mirupafshim", tregon Artemis Meron, e mbijetuar. "E keqja më e madhe ishte se ne nuk dinim asgjë, nuk kishim kështu pyesnim se çfarë ndodhi me familjarët tanë. Më pas mësuam të vërtetën. Pastaj nga larg dallonim tymin. Mendonim se gatuanin në kuzhinë, për të gjithë ata që mbaheshin të burgosur. Në atë kohë kurrë nuk e mendonim se bëhej fjalë për krematorium. Pastaj thosha me vete: për çfarë të jetoj, edhe nëse lufta mbaron? Sot mendoj, si mund të ndodhë diçka e tillë në shekullin e 20 dhe askush, asnjë vend nuk mund të ndihmojë, thjesht sepse gjermanët vendosën të shfarosin çdo hebre në botë? Pyes sepse nuk kam marrë asnjë ndihmë nga askush, as nga kryqi i kuq, i cili nuk u përfshi në këtë histori. Jam shumë e nevrikosur. Ndihehem shumë

keq për këtë gjë. Shoh fëmijët e mi, nipërit dhe mbesat dhe ky është i vetmi ngushëllim që kam".

Vera Grossman Kriegel, 81-vjeçe, është një tjetër e mbijetuar e kampit të vdekjes. Në moshën 6-vjeçare, Vera dhe motra e saj binjake iu nënshtuan eksperimenteve pseudo-mjekësore të mjekut Josef Mengele, i cili i përdorte të burgosurit e Aushvic si subjekte kërkimore, duke i dhënë atij emrin "Engjëlli i vdekjes". Vera dhe motra e saj ishin ndër të paktët fëmijë që i mbijetuar dashakeqësisë dhe makabriteteve të tij. Ajo tregon se mbahej nga doktori në një kafaz, krejt e zhveshur dhe i bëheshin injeksione direkt e në shtyllën kurrizore. Ndërsa për muaj të tërë ka parë bashkëmoshatarë të saj, të rrihen barbarisht e të ndërrojnë jetë. "Zoti donte që unë të mbetesh gjallë dhe të tregoja historinë time, - kujton ajo. Në fund të kazermave, kishte një kafaz, tamam si kafaz kafshësh, ku vendoseshin majmunë, lepuj, nuk e di, kafshë të ndryshme. Të hiqnin rrobat, ti ulesh atje. Unë dhe motra ime bashkë me nënën, bashkë me ne edhe dy binjakë të tjerë, ndoshta 10 vjeç.

Për rreth 2 javë, pa pushim, Mengele dhe ekipi i tij, nga kanë bërë gjithë kohës injeksione në shtyllën kurrizore".

"Ato gjilpëra na dhanë simptoma të tmerrshme, të vjella dhe temperaturë të lartë. Dhimbja ishte e jashtëzakonshme. Dhe ishte e ndaluar rreptësisht të qaje. Kush qante, rrihej. Ai më kapi nga jaka e palltos, më goditi dhe më hodhi në fund të bllokut, në fund të kazermave. Goditja ishte e fortë. Me vete mendoja se erdhi fundi. Por ai nuk do të shohë kurrë një pikë loti në sytë e mi. nuk ka shanse. Nuk do më thyejë. E mendoja si çdo njeri tjetër, me dy duar, një fytyrë, dy veshë. Por përse po ma bën këtë gjë? I mbaja sytë gjatë gjithë kohës të ngulura tek sytë e tij. Mengele ishte djalli vetë por kur më shihte në sy, ulte sytë".

Krime që historia do ti dënojë gjithmonë. Horrori që njerëzor është realiteti që të zgjon nga ëndrra e një makthi të frikshëm.

Kultura tradicionale shqiptare, vlerë e kultivuar ndër breza

Doket e zakonet përbëjnë një nga karakteristikat e rëndësishme etnike të çdo bashkësie shoqërore, sipas të cilave është zhvilluar jeta e popullit në të kaluarën.

Ato janë norma të krijuara nga përvoja, ligje të pashkruara të popullit, në bazë të të cilave drejtohej e qeverisej një shoqëri e caktuar. Doket e zakonet e popullit tonë, të krijuara në rrjedhën e gjatë të shekujve që nga lashtësia e gjer vonë, janë pjesë përbërëse e kulturës popullore shqiptare. Ato janë krijuar në truallin ku banojnë shqiptarët prej shekujsh dhe kanë një nënshtrat të përbashkët. Të ndara në zakone ekonomike e shoqërore, ato kanë shërbyer aktivisht për ruajtjen e individualitetit të popullit tonë. Në një vështrim tërësor që mund t'u bëjmë dokeve e zakoneve, ato i ndajmë në tri shtresa kryesore. Në shtresën e parë, më të vjetrën, bëjnë pjesë ato doke e zakone, rrënjët e të cilave duhen kërkuar në shoqërinë e lashtë.

Të tilla janë, p.sh., një pjesë e zakoneve ekonomike, disa nga zakonet familjare, disa norma juridike etj. Natyrisht, elemente rituale nga shtresa më e vjetër mund të gjenden edhe në popuj të tjerë. Por duhet pranuar, gjithashtu, se forma konkrete e praktikimit të tyre shfaqet me karakteristika të veçanta për secilin popull, duke përbërë edhe karakterin etnik të tij. Shtresa e dytë ka si bazë një përzierje botëkuptimesh, që janë rezultat i ndërthurjes së paganizmit me elemente të feve zyrtare, kristianizmit e islamizmit.

Në këto komplekse zakonesh bashkëtojnë veprime magjike pagane me koncepte kristiane dhe islame, që shfaqen në ceremonitë e lindjes, të dasmës e të vdekjes, në kalendarin popullor etj. Shtresa e fundit përfshin ato zakone që kanë ardhur si ndikim i drejtpërdrejtë i fesë. Kjo trajtesë përbën një përpjekje për të treguar vazhdimësinë e dokeve e të zakoneve të shqiptarëve të mesjetës dhe deri në ditët e sotme. Në kulturën shoqërore-shpirtërore të popullsisë së trevave të lirisë së Jugut u ruajtën doke e zakone të trashëguara nga periudha e lashtë, të cilat, sigurisht, përjetuan një përtëritje në kushtet e rendit skllavopronar. Ato vazhduan të



jetonin edhe gjatë mesjetës së hershme e të vonë. Në mesjetë, kur institucionet skllavopronare qenë përmbysur, kur peshë ekonomike e qyteteve që e vogël dhe masa e popullsisë ishte e organizuar në bashkësi fshatare, u gjallëruan përsëri si në fshat ashtu edhe në qytet organet e lashta të qeverisjes lokale, të cilat trysnia e fuqishme romake nuk kishte mundur t'i asgjësonte përfundimisht. Vazhdimi për shekuj me radhë i kësaj gjendjeje, ku mbizotëronte ekonomia natyrore dhe vepronte e drejta zakonore, krijoi mundësinë për zhvillimin e pavarur të traditave të lashta lokale dhe për pasurimin e tyre me elementë të rinj. Ashtu si popujt e tjerë, edhe shqiptarët e mesjetës kanë pasur doket e zakonet e tyre në pajtim me shkallën e zhvillimit kulturor-etnik të asaj kohe. Edhe pse burimet dokumentare për mesjetën janë fragmentare dhe nuk na lejojnë të nxjerrim përfundime të plota, duke u bazuar në to, mund të pohojmë se shqiptarët e kësaj periudhe kanë pasur doket e zakonet e tyre që dalloheshin nga të popujve të tjerë. Karli I Anzhu, në shpalljen drejtuar arbëreshëve, më 1272, thotë se: "Po i pëlqejmë... të gjitha doket e zakonet e mira të tyre... duke ua ripohuar dhe duke premtuar se do t'i mbajmë dhe do të bëjmë të mbahen nga të gjithë ata që vullnetarisht i nënshtrohen pushtetit tonë". Në shekujt XV-XVII gjejmë një numër më të madh burimesh dokumentare që flasin

për doket e zakonet e popullit tonë, tashmë të kristalizuara dhe me tipare të qarta etnike. Humanisti shqiptar Marin Barleti tregon se i pëlqejnë zakonet e lashta të popullit. Ai thekson shpesh dashurinë prindërore, dashurinë për njerëzit e shtëpisë, për prindërit, për gratë, për fëmijët, për gjënë dhe për truallin e veçantë të secilit. Atij i bëhet zemra mal kur sheh se ato ruhen dhe kërkon që fëmijët e popullit tonë të forcohen dhe të mbruhen "me zakonet tona". Frang Bardhi, duke shkruar për banorët e Shqipërisë së Veriut, thotë se: "Ata kanë shumë zakone fisnike dhe kështu, sipas zakonit të të moçmëve, në gostitë e veta, në rrugë e në punë, këndojnë me zë të lartë trimëritë e burrave të tyre të mëdhenj, dhe sidomos të të pathyeshmit Gjergj Kastrioti dhe të përndritshmit Lekë Dukagjini". Në doket e zakonet e popullit tonë vëmë re dy veçori karakteristike. Duke iu drejtuar kalendarit popullor shqiptar, vëmë re se ai ndryshon nga kalendarët popullorë të popujve fqinj, edhe nga kalendarit gregorian. Ai e ndante vitin në tetë pjesë të barabarta me nga 45 ditë, fillimi e mbarimi i të cilave ishin të lidhur me punët kryesore të stinës, me afatet e tregjeve, të panairëve etj. Dhe kaq ishin të vendosur në zbatimin e kalendarit të vjetër sa "më parë do të lejonin të vriteshin sesa t'i linin zakonet", shkruan Kerubin në relacionin e tij të vitit 1638. Në doket e zakonet shoqërore të sheku-

jve të mesjetës, gjejmë mjaft elemente pagane të trashëguara nga epokat e mëparshme. Në përgjithësi, ato përshkohen nga ideja e luftës midis së mirës e së keqes. E mira simbolizohet me figurën e dragoit dhe e keqja me atë të kuçedrës. Një element me interes i këtij botëkuptimi është koncepti mbi rolin e punës e të jetës në luftë kundër së keqes. Dragoi lufton kundër kuçedrës, duke mbajtur në njërin dorë parmendën dhe në tjetrën djepin, simbole këto të punës e të përtëritjes së jetës. Edhe në zakonet e vdekjes ruhen mjaft elemente me karakter etnik. Dhe, pavarësisht se disa syresh mund të hasen edhe në popuj të tjerë, mënyra e praktikimit të tyre është e veçantë në popullin tonë. Më e rëndësishmja është se shumë prej tyre, të përdorura në shekujt e Mesjetës së vonë, kanë ardhur të gjalla gjer në fillim të shekullit XX. P.sh. në Historinë e Skënderbeut të Barletit gjejmë të dhëna që tregojnë se shqiptarët, për të treguar dhimbjen për ata që binin në luftë, e kishin zakon të rrihnin gjoksin dhe të gërvishtnin fytyrën. Kështu vepruan banorët e Krujës gjatë kohës së rrethimit të parë të qytetit nga Sulltan Murati, kështu bëri edhe Lekë Dukagjini, i cili duke "shkukur mjekrën dhe flokët" tregoi pikëllimin e tij për vdekjen e Skënderbeut.

"Këta shqiptarë, - shkruan Frang Bardhi për popullsinë e Zadrimës, - i qajnë me gjithë zemër njerëzit e gjakut të vet... sa të gjithë shkyhen rrobash; burrat gërvishtin fytyrën me thonj deri sa të shpërthejë, rrjedhë gjaku, dhe e presin mjekrën e nuk rruhen gjithë vitin në shenjë trishtimi të madh; dhe gratë shkurttojnë flokët dhe rrahin gjokset...". Të njëjtat veprime janë hasur gjer vonë, sigurisht jo me atë forcë si më parë, edhe në shqiptarët e sotëm: në Kosovë, Kukës, Malësi të Madhe, Malësi të Lezhës, Mirditë, Malësi e Tiranës, Labëri etj. Edhe në ndërtimin e varreve të sotme dhe në ritin e varrimit gjejmë ngjashmëri me varret mesjetare. Gjurmimi i varreve të mesjetës së hershme ka rëndësi të veçantë, pasi na lejon të shkojmë më afër kuptimit të zakoneve të popullsisë së atëhershme dhe të sqarojmë përbërjen etnike dhe lidhjet kulturore me shqiptarët e sotëm.

Ku mund t'i shohim këto ngjashmëri?

Së pari, në vendosjen e kufomës në varr. Kufomat, në përgjithësi, vendosen drejt në tokë, në shpinë. Së dyti, i përbashkët është, në pjesën më të madhe, edhe orientimi i varreve lindje-perëndim me shmangie të pakta nga veriu ose jugu, sipas stinëve të vitit kur është bërë varrimi. Në orientimin e varreve ndikim ka ushtruar edhe feja. Së treti, një karakteristikë e përbashkët është edhe varrimi individual dhe varrimi kolektiv (varrime

familjare ose të vëllazërisë). Krahas tipareve themelore të përbashkëta, që, siç e pamë, janë karakteristike për gjithë shqiptarët, vihet re edhe larmia e tyre. Njësia dhe larmia e dokeve dhe e zakoneve duhen parë në zhvillimin e tyre dialektik si të lidhura e të kushtëzuara midis tyre. Raporti midis njësive e larmisë këtu shprehet midis kombëtares e krahinore. Në larminë e dokeve dhe të zakoneve të popullit kanë ndikuar një varg faktorësh, si: kushtet e ndryshme fizike-geografike të terrenit në vendin tonë, zhvillimi i ndryshëm ekonomik e shoqëror i disa krahinave, lidhjet e fqinjësisë me treva etnokulturore e të huaja, ndikimet e popujve pushtues, ndikimi i fesë etj. Në kushtet e zotërimit të ekonomisë natyrore dhe të copëzimit feudal në shekujt e mesjetës, zhvillimi ekonomik e shoqëror i krahinave etnografike të përfshira në unitete territoriale të kufizuara e relativisht të vogla, ka qenë i ndryshëm. Në zonat malore e të veçuara të vendit, ku banonte një popullsi homogjene, ruheshin doke e zakone që i përkisnin formave më të lashta të organizimit shoqëror e juridik të shoqërisë. Është e qartë se në këto rrethina me popullsi homogjene doket e zakonet janë më të ruajtura, në zona me popullsi të përzier shkrihen, njësohen, duke u bërë pronë e gjithë kësaj popullsie. Duke filluar nga fundi i shekullit XIV dhe veçanërisht nga shekulli XV, në luftën anti-os-



mane që përfshiu gjithë popullin tonë, u shpejtuan edhe ritmet e konsolidimit relativ etnik të popullit shqiptar. Kapërcimi i copëzimit feudal të vendit dhe bashkimi i të gjitha mjeteve burimore njerëzore dhe ekonomike ushtruan një ndikim të fuqishëm në forcimin e unitetit kulturor. Kjo u shpreh me një forcë të veçantë në bashkimin luftarak kundër pushtuesve të huaj, në kalitjen e vetëdijes së kombësisë, në shpërthimin e një patriotizmi të flakët, në forcimin e njësive së kulturës shoqërore e shpirtërore të shqiptarëve. Në shekujt e më vonë, veçanërisht në gjysmën e dytë të shekullit XIX e gjer në mesin e shekullit tonë, zhvillohet procesi i shuarjes dhe i thjeshtimit të disa zakoneve tradicionale të popullit tonë. E

ngjashme në disa tipare me kulturat popullore fqinje, kultura jonë paraqitet njëkohësisht e ndryshme nga ato me karakterin e veçantë që ka. Dhe si ato, edhe kjo kulturë, përveç se receptive, ka qenë edhe aktive në marrëdhëniet e saj të fqinjësisë. S'ka si të mohohet gjithashtu që edhe pushtuesit e huaj, veçanërisht pushtuesit osmanë, me anë të dhunës e të fesë kanë ndikuar në doket e zakonet e popullit tonë. Megjithatë, ky ndikim ka qenë i pakët dhe shfaqet vetëm në anë të sipërfaqshme, ndërsa thelbi i zakoneve popullore është origjinal shqiptar. Gjurmë të kontakteve me popujt e tjerë i ndeshim më tepër në terminologji. Tërma të tillë, si: gjever, darovë, bajrak, selamaz etj., që ndeshen në ceremonialin e dasmës, janë huajtur nga sllavishtja dhe turqishtja. Ky ndikim është thjeshtë gjuhësor dhe nuk ka të bëjë me thelbin e zakonit. P.sh., emri bajrak (flamuri i dasmës) nuk është marrë në lëmin e riteve, por vetëm në kuptimin flamur, domethënë në këtë rast, ekziston lidhje fillestare dhe konkrete midis flamurit të dasmës (si zakoni) dhe huazimit gjuhësor. Një faktor që ka ndikuar negativisht në procesin konvergjent të dokeve e zakoneve popullore të të gjitha krahinave ishte kisha dhe ideologjia fetare, mbështetëse të rendit feudal. Me pushtimin osman, në vendin tonë u përhap edhe islamizmi. Përgarja fetare e popullit shqiptar në tri besime armiqësore

midis tyre, ndonëse krijoi vështirësi në zhvillimin unitar historiko-kulturor, nuk mundi të zhdukë zakonet e popullit tonë të trashëguara nga brezat e mëparshëm. Trashëgimia etnokulturore e përbashkët, e përforcuar në bazë të një zhvillimi historik, ekonomik shoqëror territorial unitar, i bëri ballë veprimit përndarës të faktorit fetar, me gjithë gjurmët që la ai. Dokumentet e kohës tregojnë se shqiptarët pak vëmendje u kushtojnë dogmave. Ekzistenca e shumë zakoneve të përbashkëta para kristiane në të gjitha shtresat e popullit dhe në gjithë krahinat ka ndihmuar, pa ditur, për ruajtjen e njësive së dokeve e të zakoneve tona.



Forumi Ekonomik Botëror në Davos, “Rivendosja e sigurisë dhe paqes”

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s bën thirrje për më shumë mbështetje për Ukrainën

Përshtati: MIMOZA GOLIKJA

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg mori pjesë në Takimin Vjetor të Forumit Ekonomik Botëror në Davos, Zvicër, më 18 janar 2023, ku ai gjithashtu bëri thirrje për më shumë mbështetje për Ukrainën.

Në seancën plenare mbi temën “Rivendosja e sigurisë dhe paqes”, Sekretari i Përgjithshëm theksoi se aleatët e NATO-s kanë ofruar mbështetje të paprecedentë për të ndihmuar Ukrainën të ruajë të drejtën e saj të vetëm-brojtjes dhe bëri thirrje që dërgesat e pajisjeve ushtarake të rriten në këtë kohë kritike. “Armët janë rruga drejt paqes, - tha ai, - ajo që ndodh rreth tryezës së bisedimeve varet tërësisht nga forca në fushën e betejës. Dhe nëse duam që Ukraina të mbizotërojë, atëherë atyre u duhet forca ushtarake”.

Sekretari i Përgjithshëm e përshkroi luftën në Ukrainë si një luftë për demokraci, dhe tha se është jashtëzakonisht e rëndësishme që Presidenti Putin të mos e fitojë këtë luftë. “Do të jetë një tragjedi për ukrainasit, por edhe shumë e rrezikshme për të gjithë ne, - theksoi ai, - sepse atëherë mesazhi për liderët autoritarë, jo vetëm për Putinin, por edhe për liderët e tjerë autoritarë është se kur përdorin forcën brutale, kur shkelin ligjin ndërkombëtar, arrijnë atë që duan. Dhe ky do të jetë një mësim shumë i keq dhe i rrezikshëm. Do ta bëjë botën më të rrezikshme dhe ne më të pambrojtur”, - nënvizoi Stoltenberg.

Pjesëmarrës të tjerë në panelin “Rivendosja e sigurisë dhe paqes”, ishin Presidenti i Polonisë Andrzej Duda, zëvendëskryeministria e Parë dhe ministria e Ekonomisë Yulia Svyrydenko e Ukrainës, zëvendëskryeministria dhe ministria e Financave e Kanadasë Chrystia Freeland dhe Drejtori i Inteligjencës Kombëtare të SHBA-ve Avril Haines. Diskutimi u moderua nga Fareed Zakaria i CNN.

Gjatë qëndrimit në Davos, z. Stoltenberg pati dhe takime dypalëshe si ai me Presidentin e Lituaniës Gitanas Nausėda dhe gjithashtu u takua me këshilltaren federale zvicerane Viola Amherd, shefe e Departamentit Federal të Mbrojtjes, Mbrojtjes Civile dhe Sporteve, takim me Zonjën e Parë të Ukrainës Olena Zelenska, takim me Profesor Klaus Schwab, Themelues dhe Kryetar Ekzekutiv i Forumit Ekonomik Botëror, dhe zyrtarë të tjerë të lartë.

Rëndësia e mbështetjes afatgjatë për Ukrainën

Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky përsëriti të mërkurën e 18 janarit edhe njëherë dëshirën e tij që Ukraina të anëtarësohet në NATO, duke u thënë udhëheqësve të mbledhur në Forumin Ekonomik Botëror se aleanca është garancia më e mirë e sigurisë për Ukrainën. “Garancitë e sigurisë janë ndër prioritetet kryesore për ne”, - tha Zelensky virtualisht përmes përkthyesit në përgjigje të pyetjes drejtuar nga moderatori i panelit Fareed Zakaria i CNN. “Ne e kuptojmë se për momentin, ne nuk jemi ende atje, për fat të keq, Rusia e kupton mirë këtë dhe ata bëjnë të pamundurën që të mos na e bëjnë të lehtë anëtarësimin. Por ne jemi në rrugën drejt NATO-s, sepse NATO është garancia më e mirë e sigurisë për ne, për vendin tonë, për fëmijët tanë”, - tha presidenti ukrainas. Ndërsa një ditë më parë, më 17 janar, ish-sekretari

amerikan i Shtetit, Henry Kissinger tha se ndërsa Ukraina duhet të mbështetet, Ruisë duhet t'i jepet mundësia për të qenë anëtare e rendit global. I pyetur për komentet e Kissinger-it në lidhje me vendin e Ruisë në botë, Zelensky tha se: "Rusia tashmë ka fituar një vend në mesin e terroristëve dhe prioriteti ynë sot, detyra jonë politike sot është të shohim liderë dhe figura të ndryshme politike, ata që janë ende shumë të rëndësishëm ose kanë qenë të rëndësishëm deri vonë, që ata të jenë në gjendje të njohin gabimin e madh që kreu Putini, të njohin se ky është agresioni i Ruisë", - shtoi Zelensky.

Në fjalën e tij gjatë diskutimit në panelin "Rivendosja e sigurisë dhe paqes", Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s komentoi rreth çështjes nëse do t'i mundësohej Ukrainës të hynte në Aleancë, pasi Presidenti i Ukrainës e ka ripërsëritur sërish se do të dëshironte që vendi i tij të ishte anëtar i NATO-s. "Qëndrimi i NATO-s mbetet i pandryshuar dhe ai është se Ukraina do të bëhet anëtare e NATO-s, por fokusi kryesor tani është të mbështesë Ukrainën, për të siguruar që Ukraina të fitojë luftën dhe të mbizotërojë si një komb demokratik sovran dhe i pavarur në Evropë", - tha Jens Stoltenberg. "Kjo është arsyeja pse aleatët e NATO-s, partnerët, po ofrojnë mbështetje të paprecedentë ushtarake për Ukrainën dhe pse unë po udhëtoj nëpër kryeqytetet e NATO-s dhe po u bëj thirrje atyre të bëjnë edhe më shumë, dhe pse e mirëpres njoftimin e fundit për më shumë armaturë, mbrojtje ajrore më të avancuar sistemeve. Së fundmi nga Kanadaja me 200 automjete të blinduara dhe, gjithashtu, Polonia, duke ofruar më shumë armë dhe natyrisht, SHBA-ja udhëheq të gjitha këto përpjekje në atë që ne e quajmë Grupi i Kontaktit i këtij grupi mbështetës për Ukrainën", - tha shefi i NATO-s. Stoltenberg përsëriti gjithashtu se "është jashtëzakonisht e rëndësishme që Presidenti Putin të mos e fitojë këtë luftë, pjesërisht sepse do të jetë një tragjedi për ukrainasit, por do të jetë shumë e rrezikshme për të gjithë ne, sepse atëherë mesazhi për liderët autoritarë, jo vetëm për Putinin, por edhe për liderët e tjerë autoritarë, është se kur përdorin forcën brutale, kur shkelin ligjin ndërkombëtar, arrijnë atë që duan. Dhe ky do të jetë një mësim shumë i keq dhe i rrezikshëm. Do ta bëjë botën më të rrezikshme dhe ne më të pambrojtur. Kjo është arsyeja, pse nëse duam një zgjidhje paqësore të negociuar të luftës në Ukrainë, ne duhet t'i ofrojmë mbështetje ushtarake Ukrainës. Kjo është e vetmja mënyrë", - tha ai.

